



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR

MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E
LEGJISLACIONIT TË SHËRBIMIT CIVIL

BASHKIA ELBASAN

Tiranë, Prill 2017

RAPORT PËRFUNDIMTAR

Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Elbasan

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të planit vjetor të punës, miratuar me vendimin nr. 1, datë 06.01.2016, nëpërmjet Vendimit nr.41, datë 18.04.2016, *“Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Elbasan”*, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në institucionin e Bashkisë Elbasan.

Për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, organet e qeverisjes vendore, të konstituara pas zgjedhjeve të vitit 2015, organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen e re administrative, përcaktuar në ligjin nr. 115/2014, *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”*.

Në rastin konkret, shtrirja territoriale e Bashkisë Elbasan, përveç qendrës, përfshin edhe **12** njësi vendore të organizuara sipas ligjit të mëparshëm, si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, që janë, Komuna Tregan, Komuna Shirgjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Zavalinë, Komuna Gjinar, Komuna Bradashesh, Komuna Funar, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Shushicë, Komuna Gracen dhe Komuna Labinot-Fushë, të cilat, në bazë të ligjit nr. 30/2015, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, të ndryshuar, aktualisht janë organizuar si njësi administrative, struktura dhe organika e të cilave, pas kësaj do të jenë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Elbasan.

Në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”*, Kreu III, *“Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve”*, pika 1, përcaktohet se bashkia është trashëgimtari ligjor i njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ, të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrië. Më tej, në Kreun IV të këtij akti nënligjor, *“Transferimi i personelit”*, parashikohet gjithashtu, se marrëdhëniet e punës ekzistuese, ndërmjet njësive që janë shkrië dhe punonjësve të tyre, do të transferohen në bashki, në momentin e konstituimit të organeve të kësaj të fundit.

Në këto rrethana të reja, të krijuara për shkak të riformatimit të njësive të qeverisjes vendore, ky raport me konkluzionet e tij, si dhe vendimi përkatës i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për miratimin e raportit përfundimtar, do t'i drejtohen për zbatim njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, si institucioni përgjegjës në këtë rast.

Mbikëqyrja u realizua sipas programit të mbikëqyrjes miratuar me vendimin nr. 336/1 prot., datë 18.04.2016, të Komisionerit, i cili i është njoftuar institucionit me shkresën nr. 336/2 prot., datë 18.04.2016 “Njoftim për fillimin e mbikëqyrjes”.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm dhe përfshin verifikimin e zbatimit të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar nga ana e njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, në lidhje me të gjithë institutet e tij, ndër të cilat, rekrutimi, disiplina, vlerësimi i punës, përkrimi i punës, e aspekte të tjera që trajtohen nga ky ligj.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës i përbërë nga inspektorët Gentiana Agushi dhe Alda Xhaxhiu, nën drejtimin teknik të Drejtorit të Mbikëqyrjes, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit të nëpunësve në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Elbasan, të cilin ia ka dërguar për njohje institucionit me shkresën nr. 336/3 prot., datë 16.09.2016, duke i lënë 15 ditë kohë, për të paraqitur observacionet.

Në vijim të procesit dhe në përfundim të afatit që i është lënë institucionit për të paraqitur observacionet përkatëse, rezulton se, nga ana e Bashkisë Elbasan nuk janë paraqitur vërejtje lidhur me materialin dhe as projektraporti nuk është kthyer i firmosur nga personat përgjegjës.

Në këto rrethana, Komisioneri e vlerëson si të përmbushur detyrimin për të njohur subjektin me gjetjet e grupit të mbikëqyrjes dhe çmon se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar. Për këtë arsye, procesi i mbikëqyrjes do të vijojë me dërgimin e raportit përfundimtar dhe të vendimit përkatës për miratimin e tij.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit.
- Paralajmërimin e institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimi të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë edhe detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me

statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë të institucionit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.

2. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Verifikimi i faktit të përfshirjes ose jo të funksionit në shërbimin civil, në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
 - Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm, nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit Civil”, apo për një periudhë jo më të vogël se 1 vit;
 - Nëpunësit ekzistues që janë të punësuar në pozicione, pjesë të shërbimit civil sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese, ose që kanë më pak se një vit në këto pozicione pune;
 - Rastet e refuzimit të deklarimit të statusit të nëpunësit civil;
 - Si është dokumentuar në dosjen e personelit procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e verifikimit dhe deklarimit të statusit të punësimit të punonjësve (kërkesat e përgjithshme, kërkesat e posaçme, procedura e rekrutimit, akti i emërimit, etj.).
3. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës sipas formatit të përcaktuar nga ligji për nëpunësin civil dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij, që do të verifikohet në këto aspekte:
 - Si është zbatuar procedura e hartimit të përshkrimit të punës dhe formati i miratuar me aktin nënligjor përkatës.
 - Verifikimin e faktit nëse punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
 - Punonjësit që janë të emëruar aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, i plotësojnë kërkesat e posaçme, sipas formularit të përshkrimit të punës.
4. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil.
5. Rastet e rekrutimeve, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
6. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*detyrimet e nëpunësit dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
7. Transferimi i përkohshëm dhe transferimi i përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste (*ristrukturimi dhe ngritja e komisionit përkatës, aktet që materializojnë procesin, si dhe rastet e tjera të transferimit*).
8. Pezullimi nga shërbimi civil, sipas rasteve të parashikuara në ligj dhe si janë zbatuar kërkesat ligjore gjatë procedurës së zhvilluar në këto raste.

9. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore të kërkuar në fazat e zhvillimit të ecurisë disiplinore (kërkesa për fillimin e ecurisë, ngritja e Komisionit të përhershëm).
10. Vlerësimi i rezultateve në punë dhe si është zhvilluar ky proces pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Si materializohet procedura e vlerësimit dhe detyrimet ligjore që ligji i ka vendosur aktorëve të këtij procesi gjatë vitit të vlerësimit (*Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues*).
11. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil: si rezultat i dorëheqjes dhe për shkak të ligjit.
12. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i mbikëqyrjes ka përdorur si metodë pune, verifikimin në subjekt të dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, që administrohet në dosjet individuale të personelit në arkivin e institucionit, si dhe dokumentacionit të ndodhur në sektorin e financës, për çdo nëpunës të emëruar në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht, u realizua një takim me Kryetarin e Bashkisë dhe Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Organizative, gjatë të cilit u diskutua mbi objektin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej të vihej në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas strukturës dhe organigramës së institucionit.
- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe dosjet individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji, për plotësimin e kërkesave të përgjithshme që duhet të plotësojnë nëpunësit për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera për marrëdhëniet e punës të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës si niveli arsimor, përvoja në punë, etj.
- U administrua dokumentacioni i kërkuar, ku përfshihen listëprezencat dhe borderotë e pagesës së punonjësve për periudhën shkurt 2014 dhe për periudhën mars 2016.
- U verifikua ligjshmëria e gjithë akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil të lëshuara nga njësia e personelit, për gjithë nëpunësit e bashkisë.

Konstatimet janë të materializuara si anekse më vete (*Tabela nr. 1, Tabela nr. 2, Tabela nr. 3, Tabela nr. 4, Tabela nr. 5, Aneksi nr. 2 dhe Aneksi nr. 3*), të cilat janë të organizuara në formën e tabelave dhe janë pjesë e pandarë e këtij raporti.

Përmbajtja e raportit:

- I. **Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me procesin e deklarimit të statusit të punësimit**

a) Vlerësimi i procesit të ndarjes së pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, nga numri i përgjithshëm i pozicioneve të punës në Bashkinë Elbasan, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2, të këtij ligji, përcaktohet se në fushën e veprimit të tij përfshihet çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore dhe njëkohësisht evidentohen dhe rastet e përjashtuara nga shërbimi civil, të identifikuar shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit.

Institucioni i Bashkisë, është krijuar dhe funksionon mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, i cili, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore, e për këtë arsye në bazë të nenit 2, pika 4, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, që ishte në fuqi në atë kohë, ky subjekt është përfshirë në shërbimin civil, gjë e cila është konfirmuar edhe nga neni 2, paragrafi i I-rë, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që është aktualisht në fuqi.

Administrimi i shërbimit civil në këtë institucion, në zbatim të nenit 32, germa ”ç”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, është bërë mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Bashkiak Elbasan.

Më poshtë, duke pasur parasysh objektin e mbikëqyrjes, që ka lidhje edhe me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që është data 26.02.2014, po i analizojmë në mënyrë të detajuar, problematikat sipas ligjit të kohës, kur njësitë e sotme administrative, kanë qenë subjekte më vete, të organizuara si njësi të pavarura të qeverisjes vendore, me statusin e Komunave.

I.a.1) Bashkia Elbasan

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, në datën 26.02.2014, pra, ditën e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Bashkia Elbasan ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 2, datë 05.02.2014, të Këshillit të Bashkisë Elbasan.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, kjo Bashki kishte gjithsej **213** pozicione pune, nga të cilat, **150** pozicione pune ishin pjesë e shërbimit civil, (që zenë **70%** të numrit total të pozicioneve të punës) kurse pjesa tjetër ishin pozicione pune jashtë shërbimit civil.

Duke bërë klasifikimin e pozicioneve pjesë përbërëse e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, pozicionet e punës së administratës së Bashkisë Elbasan, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **6** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor i Përgjithshëm*”, që zënë **4%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **19** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”, që zënë **13%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **24** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor*”, që zënë **16%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **101** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist/Inspektor*”, që zënë **67%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

I.a.2) Komunat, aktualisht Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan

Bashkia Elbasan, përveç qendrës, përfshin edhe **12** njësi të pavarura të qeverisjes vendore, që janë, Komuna Tregan, Komuna Shirgjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Zavalinë, Komuna Gjinar, Komuna Bradashesh, Komuna Funar, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Shushicë, Komuna Gracen dhe Komuna Labinot-Fushë.

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, 12 komunat, aktualisht njësi administrative kanë qenë të organizuara dhe funksiononin mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar respektivisht si më poshtë:

1. **Komuna Tregan** - me Vendimin nr. 17, datë 30.01.2013, të Këshillit të Komunës Tregan.
2. **Komuna Shirgjan** - me Vendimin nr. 43, datë 25.10.2013, të Këshillit të Komunës Shirgjan.
3. **Komuna Labinot-Mal** - me Vendimin nr. 5, datë 24.02.2014, të Këshillit të Komunës Labinot-Mal.
4. **Komuna Zavalinë** – me Vendimin nr. 5, datë 23.05.2013, të Këshillit të Komunës Zavalinë.
5. **Komuna Gjinar** – me Vendimin nr. 91, datë 15.03.2013, të Këshillit të Komunës Gjinar.
6. **Komuna Bradashesh** – me Vendimin nr. 3, datë 20.01.2014, të Këshillit të Komunës Bradashesh.
7. **Komuna Funar** – me Vendimin nr. 6, datë 21.02.2014, të Këshillit të Komunës Funar.
8. **Komuna Papër** – me Vendimin nr. 39, datë 24.12.2013, të Këshillit të Komunës Papër.
9. **Komuna Gjergjan** – me Vendimin nr. 21, datë 14.02.2014, të Këshillit të Komunës Gjergjan.
10. **Komuna Shushicë** – me Vendimin nr. 4, datë 30.01.2014, të Këshillit të Komunës Shushicë.
11. **Komuna Gracen** – me Vendimin nr. 1, datë 31.01.2014, të Këshillit të Komunës Gracen.

12. Komuna Labinot-Fushë – me Vendimin nr. 67, datë 15.02.2013, të Këshillit të Komunës Labinot-Fushë.

Bazuar në strukturat respektive organizative të secilës ish-komunë, po i japim të detajuara në tabelën e mëposhtme numrin total të punonjësve, pozicionet pjesë përbërëse e shërbimit civil dhe përqindja që zënë këto pozicione pune në raport me numrin e përgjithshëm të punonjësve.

Tabela nr. 1 - Numri i nëpunësve civilë në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës në ish-komunat e rrethit Elbasan

Nr.	Institucioni	Punonjës gjithsej	Pozicione në shërbimin civil	Përqindja e pozicioneve të shërbimit civil
1.	Komuna Tregan	15	8	53%
2.	Komuna Shirgjan	33	9	28%
3.	Komuna Labinot-Mal	21	8	38%
4.	Komuna Zavalinë	14	5	36%
5.	Komuna Gjinar	22	8	36%
5.	Komuna Bradashesh	28	14	50%
7.	Komuna Funar	11	3	27%
8.	Komuna Papër	46	15	33%
9.	Komuna Gjergjan	21	9	43%
10.	Komuna Shushicë	26	9	35%
11.	Komuna Gracen	15	4	26%
12.	Komuna Labinot-Fushë	14	5	36%

Duke bërë klasifikimin e pozicioneve pjesë përbërëse e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në 12 ish-komunat në mënyrë respektive, ndahen në këtë mënyrë si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2 - Klasifikimi i pozicioneve në shërbim civil sipas kategorive në ish komunat e rrethit Elbasan

Nr.	Institucioni	“Përgj. Sektori/Zyre”	“Specialist/Inspektor”
1.	Komuna Tregan	2	6
2.	Komuna Shirgjan	2	7
3.	Komuna Labinot-Mal	5	3
4.	Komuna Zavalinë	2	3
5.	Komuna Gjinar	2	6
5.	Komuna Bradashesh	5	9
7.	Komuna Funar	1	2
8.	Komuna Papër	4	11
9.	Komuna Gjergjan	2	7

10.	Komuna Shushicë	2	7
11.	Komuna Gracen	2	2
12.	Komuna Labinot-Fushë	2	3

► **Situata e përgjithshme e pozicioneve në shërbimin civil në datën 26.02.2014**

Në përfundim të analizës së të dhënave të mësipërme në lidhje me situatën e shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe në 12 ish-Komunat, që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se janë verifikuar gjithsej **247** pozicione pune, që bëjnë pjesë në shërbimin civil (**51 %**) nga **479** që ishte numri total i pozicioneve të punës në Bashkinë Elbasan.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **247** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe në ish-Komunat, që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **6** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor i Përgjithshëm”, që zënë **2%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **19** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, që zënë **8%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **55** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor”, që zënë **22%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **167** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist/Inspektor”, që zënë **68%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

Konkluzion: Në lidhje me metodologjinë e ndjekur për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e analizuara më sipër, Komisioneri vlerëson se, është ruajtur një raport i drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë shërbime mbështetëse, apo që bëjnë pjesë tek njësitë publike direkte të shërbimit.

► **Situata aktuale e pozicioneve në shërbimin civil në momentin e mbikëqyrjes**

Ndërkohë, në momentin e kryerjes së procesit të mbikëqyrjes, sipas strukturës provizore të institucionit, të miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan, nr. 484, datë 23.03.2016, “Për miratimin e strukturës provizore të Bashkisë Elbasan për vitin 2016”, rezultojnë **207** pozicione pune që bëjnë pjesë në shërbimin civil (**53%**), nga **388** pozicione pune në total.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve në shërbimin civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, **207** pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe në 12 ish-Komunat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, ndahen në këtë mënyrë:

- Nëpunës civilë të nivelit të lartë drejtues janë **7** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor i Përgjithshëm”, që zënë **3%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues janë **24** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, që zënë **12%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **33** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori/Kryeinspektor”, që zënë **16%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **143** pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist/Inspektor”, që zënë **69%** të numrit të përgjithshëm të pozicioneve në shërbimin civil.

Në mënyrë të detajuar, kjo gjendje është pasqyruar në tabelën **Aneks nr. 3** - “Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil, të Bashkisë Elbasan dhe Njësi Administrative për vitin 2016”, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Në lidhje me metodologjinë e ndjekur për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e analizuara më sipër, Komisioneri vlerëson se, është ruajtur një raport i drejtë midis pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, nga ato që kryejnë shërbime mbështetëse, apo që bëjnë pjesë tek njësitë publike direkte të shërbimit.

II. Verifikimi i kushteve ligjore për përfitimin e statusit të nëpunësit civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij

Fillimi i efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, kushtëzoi procesin e deklarimit të statusit të punësimi, sipas nenit 67, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar me VKM nr.532, datë 06.08.2014. Punonjësit e bashkisë përfituan statusin si nëpunës civilë/punonjës ekzistues, kurse punonjësit e komunave, meqënëse përfshiheshin për herë të parë në shërbimin civil, përfituan këtë status vetëm, si punonjës ekzistues.

Për kryerjen e këtij procesi, duhej të mbaheshin parasysh neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, i cili përcakton në mënyrë të shprehur rregullat e mëposhtme:

- pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues”, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “*Statusi nëpunësit civil*”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë;
- pika 4, “Nëpunësit ekzistues”, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji;
- pika 6, “*Deklarimi i statusit të punësimit*”, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse, pas verifikimit të procedurës dhe kohëzgjatjes së punësimit.

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar*”, Kreu II, “*Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet*”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3, të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji i mëparshëm, nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Dispozitat e sipërpërmendura, përbëjnë kuadrin ligjor të zbatueshëm për deklarin e statusit të punësimit pas verifikimit të procedurës së punësimit për gjithë nëpunësit që mbanin pozicione pune të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Mbështetur në këtë bazë ligjore, për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësi përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit për deklarin e statusit të punësimit, u verifikuan dhe u analizuan të gjitha materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, përskrimet e punës, kohën e fillimit të punës, organigramën dhe strukturën e institucionit, e cila ka qenë efektive në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, (*listëprezencën dhe listëpagesën e muajit shkurt 2014*), si dhe aktet që pasqyrojnë procedurat e rekrutimit për nëpunësit e emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Pas analizës së situatës, për realizimin e objektivit të mësipërm, bazuar në strukturën analitike që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe dokumentacionin e administruar gjatë procesit të mbikëqyrjes, duke marrë si kriter procedurën e zbatuar për plotësimin e këtyre pozicioneve, situata rezulton si më poshtë:

II.a) Gjendja e deklarin të statusit të punësimit në Bashkinë Elbasan dhe në ish-Komunat që aktualisht janë Njësi Administrative të këtij institucioni, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, data 26.02.2014

- *Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, parashikuar në ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.*

II.a.1) Bashkia Elbasan

Nga analiza e dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kjo njësi ka qenë e organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 8, datë 28.01.2014, “*Mbi Strukturën Organizative të Administratës së Bashkisë, Sektorit Ndhmës, Institucioneve dhe Ndërmarrjeve vartëse të saj, për vitin 2014*”, të Këshillit të Bashkisë Elbasan.

Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton që kjo bashki, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka pasur **150** pozicione pune pjesë të shërbimit civil, nga të cilat **78** nëpunës civilë kanë qenë të punësuar në respektim të *procedurave të konkurrimit*, sipas kërkesave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*” dhe të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë *më tepër se 1 vit*, ndërkohë që punonjësit e tjerë ishin punësuar nëpërmjet akteve të thjeshta të emërimit, pa kryer më parë konkurrimin.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre, rezulton në **78** rastet, e përmendura më sipër, janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, për pranimin në shërbimin civil. Kështu, është shpallur pozicioni i lirë në dy gazetatat me qarkullimin më të madh; është krijuar komiteti *ad-hoc*; ka dalë akti i përzgjedhjes dhe i emërimit, si dhe akti i konfirmimit si nëpunës civilë.

Me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse, me të drejtë për këto **78 raste**, në muajin qershor 2014, ka nxjerrë aktet e deklarimit të statusit si “*nëpunës civil*”, në përputhje me pikën 3, të nenit 67, të ligjit në fjalë dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

Aktet administrative që evidentojnë specifikat e tyre, si procedurën e rekrutimit apo aktet e emërimit, janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 1** - “*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me konkurrim sipas ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe të konfirmuar si nëpunës civilë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan*”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se në gjithë rastet e përmendura më sipër, njësia e burimeve njerëzore, ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në dispozitën e nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

II.a.2) Komunat, aktualisht Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan

Ashtu si e përshkruam edhe më sipër, Bashkia Elbasan, përveç qendrës, përfshin edhe **12** njësi të pavarura të qeverisjes vendore, që janë, Komuna Tregan, Komuna Shirgjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Zavalinë, Komuna Gjinar, Komuna Bradashesh, Komuna Funar, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Shushicë, Komuna Gracen dhe Komuna Labinot-Fushë.

Këto njësi të pushtetit vendor, kanë qenë institucione që pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë përfshirë për herë të parë në shërbimin civil.

Më parë, marrëdhëniet e punës të punonjësve të tyre rregulloheshin në bazë të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe nuk ekzistonte ndonjë detyrim që punësimi të kryhej nëpërmjet procedurës së konkurrimit, qoftë edhe si procedurë e jashtme.

Përfitimi i statusit të nëpunësit civil për punonjësit e tyre, ka lindur për shkak të veprimit të nenit 67, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- **Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar**

II.a.3) Bashkia Elbasan

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, konstatohet se, në datën 26.02.2014, që përkon me momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Bashkia Elbasan ka qenë e organizuar dhe ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 8, datë 28.01.2014, “Mbi Strukturën Organizative të Administratës së Bashkisë, Sektorit Ndihmës, Institucioneve dhe Ndërmarrjeve vartëse të saj, për vitin 2014”, të Këshillit të Bashkisë Elbasan.

Sipas kësaj strukture organizative, kjo bashki ka pasur **150** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, prej të cilave në **34** raste, janë emëruar punonjës me akte emërimi të përkohshme dhe me kontrata pune, duke mos respektuar procedurat e konkurrimit, ashtu si përcaktohej në nenin 13, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Megjithatë, me fillimin e efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pavarësisht shkeljes ligjore të lejuar në lidhje me mënyrën e fillimit të marrëdhënies së punësimit, këta punonjës kanë përfitur të drejtën e statusit të nëpunësit civil, në bazë të nenit 67, të këtij ligji.

Bazuar në këtë dispozitë ligjore dhe në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar,” të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar,

njësia e burimeve njerëzore ka kryer procesin e deklarimit të statusit të punësimit, për të gjithë punonjësit që ishin efektivë në datën 26.02.2014.

➤ **Rastet e deklarimit të statusit të punësimit**

Gjendja e deklarimit të statusit të punësimit për **34** rastet e emëruar në pozicione pune të shërbimit civil, në kundërshtim me ligjin, nëpërmjet akteve të emërimit të përkohshëm dhe me kontrata pune, paraqitet si më poshtë:

- Në 20 raste, kanë qenë punonjës ekzistues, me një kohëzgjatje punësimi më tepër se një vit dhe për këtë arsye, nga ana e njësisë përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit si “nëpunës civil”

Nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se në **20 raste**, siç u tha dhe më sipër, kanë qenë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit.

Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pavarësisht se fillimi i marrëdhënieve të tyre është bërë pa respektuar procedurat e konkurrimit sipas ligjit nr. 8549, datë. 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, kanë patur më shumë se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014.

Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “nëpunës civil”, nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin maj 2014, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 2** – “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), të cilët kishin më shumë se një vit, në pozicionin e punës, në Bashkinë Elbasan”. Kjo tabelë është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në gjithë rastet e përmendura më sipër, njësia e burimeve njerëzore, ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

- Në 14 raste, kanë qenë punonjës të cilët në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, ishin të punësuar për një periudhë më pak se një vit, prandaj nga ana e njësisë përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit si “nëpunës civilë në periudhë prove”

Nga këqyrja e akteve dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton se në **14 raste**, janë konstatuar marrëdhënie pune, të cilat

në datën e fillimit të efekteve juridike të ligjit në fjalë (në datën 26.2.2014) kishin kohëzgjatje më pak se 1 vit në atë pozicion pune.

Për këtë kategori punonjësish, njësia përgjegjëse, në përputhje me nenin 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit si “nëpunës civilë në periudhë prove”.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 3** – “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të cilët kishin më pak se një vit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), Bashkinë Elbasan”. Kjo tabelë është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Gjatë procesit të verifikimit të rasteve të mësipërme, konkretisht u konstatuan 2 raste të nëpunësve civilë në periudhë prove, me parregullsi në procesin e deklaramit të statusit të punësimit, si më poshtë:

- *****, në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave”, ka filluar punë me urdhrin nr. 410, datë 10.10.2013, në këtë pozicion. Akti i deklaramit të statusit të tij të punësimit është në kategorinë “nëpunës civil në periudhë prove” dhe mban nr.369, datë 02.07.2014. Aktualisht, ky punonjës është konfirmuar si “nëpunës civil” me vendimin nr. 53, datë 17.02.2015. Grupi i punës konstatoi se në dosjen individuale të personelit, për këtë punonjës, mungonte njehsimi i diplomës (Bachelor) sipas kërkesave të ligjit, pasi i kishte kryer studimet jashtë shtetit.
- *****, në pozicionin e punës, “Drejtore në Drejtorinë e Kujdesit Social”, i cili ka filluar punë me urdhrin nr. 117, datë 21.03.2013, në këtë pozicion. Akti i deklaramit të statusit të tij të punësimit është në kategorinë “nëpunës civil në periudhë prove” dhe mban nr. 300, datë 14.06.2014. Aktualisht, ky punonjës është i konfirmuar si “nëpunës civil”, me vendimin nr. 58, datë 17.02.2015, të eprorit, ndërkohë që në dosjen e tij të personelit mungon akti i vlerësimit të rezultateve të punës, në përfundim të periudhës së provës. Konstatohet se, aktualisht, me urdhrin nr. 669, datë 03.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë, ai ka kaluar në pozicionin e punës, “Zëvendës Kryetar i Bashkisë Elbasan”, i cili nuk është pjesë e shërbimit civil. Konstatohet se, nga ana e njësisë përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan nuk është kryer procedura e pezullimit nga shërbimi civil, për punonjësin *****, sipas kërkesave të neneve 53 deri 56 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në kushtet kur ai ka kandiduar dhe është zgjedhur në një prej pozicioneve të parashikuara në pikën 1/a të nenit 54 të ligjit në fjalë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se në **12** raste, të përmendura më sipër, njësia përgjegjëse ka vepruar drejt në lidhje me deklaramin e statusit të punësimit si “nëpunës civilë në periudhë prove”, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 4 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për

zbatim të tij. Konkretisht, për të gjithë rastet që iu ka përfunduar periudha e provës, është realizuar programi i trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë.

Në dosjet e këtyre nëpunësve janë të administruara certifikatat përkatëse, të lëshuara nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA), vlerësimi i punës dhe vendimi i eprorit direkt, shoqëruar me mendimin e nëpunësit civil më të vjetër. Kjo procedurë ka përfunduar duke u konkretizuar me aktet përkatëse të konfirmimit të nëpunësit, si nëpunës civil, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, Komisioneri vlerëson se për **2** rastet e tjera të evidentuara më lart, për punonjësit:

- ******, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të plotësojë menjëherë dosjen e personelit me formularin e vlerësimit të punës dhe të nxjerrë aktin e pezullimit nga shërbimi civil, sipas kërkesave të neneve 53 deri 56, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;
- ******, njësia përgjegjëse duhet të administrojë menjëherë në dosjen e personelit, aktin e njehsimit të diplomës (*Bachelor*), sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe rregullave të parashikuara në ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.

➤ Rastet e mosdeklarimit të statusit të punësimit

Nga këqyrja e akteve dhe analiza që i është bërë rasteve të mosdeklarimit të statusit të punësimit, konstatohet se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan në **21 raste**, nuk ka deklaruar statusin e punësimit, për punonjës që fillimi i efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil, i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, (pasqyruar kjo, në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”. Kjo tabelë është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Arsyet e mos deklarimit të statusit të punësimit, specifikohen si më poshtë:

- **8 raste**, për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor (arsim i mesëm)
- **4 raste**, për shkak se janë shkëputur marrëdhëniet e punës përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit (pension)
- **5 raste**, për shkak se janë liruar nga shërbimi civil përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit (dorëheqje)
- **4 raste**, kur pozicioni i punës gabimisht nuk është konsideruar pjesë e shërbimit

Këto raste po i analizojmë në mënyrë të detajuar në vijim:

- Rastet e mosdeklarimit të statusit për shkak, të mplotësimit të kriterit arsimor

Gjatë procesit të verifikimit, konstatohet se, në **8 raste**, megjithëse pozicionet e punës bënin pjesë në shërbimin civil, ishin emëruar punonjës të cilët nuk plotësonin kriterin e nivelit arsimor. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste, në Sektorin e Ndhmës Ekonomike në Drejtorinë e Kujdesit Social, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste në Arshiva Teknike në Drejtorinë e Planifikimit e Kontrollit të Territorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhmës Ekonomike Rajoni nr. 4”;
4. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Rajoni nr. 5”;
5. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhmes Ekonomike”;
6. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhmes Ekonomike”;
7. *****, në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Kontrollit në Drejtorinë e Tatim Taksave”;
8. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhmes Ekonomike”.

Përbushja e kriterit arsimor, është një element i domosdoshëm për lindjen ose ekzistencën e një marrëdhënie pune në shërbimin civil, kërkesë kjo e parashikuar shprehimisht, në shkronjën “e” të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Për ata punonjës të bashkisë, apo ish komunave, që nuk plotësojnë këtë kriter, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, i ndryshuar të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia e burimeve njerëzore, duhet të kishte vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit.

Në lidhje me këto raste, u konstatua se këta punonjës nuk plotësojnë kriteret për të mbajtur pozicionet përkatëse, për shkak të mungesës së arsimit të lartë. Megjithëse për këto raste është konstatuar një mangësi e tillë, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt, duke mos nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të nëpunësit civil dhe të vendoste përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, e cila është pjesë e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan në këto raste nuk ka vepruar drejt, sepse duhet të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këta punonjës, si më poshtë:

1. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Rajoni nr. 5”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhmes Ekonomike”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhmes Ekonomike”;
4. *****, në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Kontrollit në Drejtorinë e Tatim Taksave”;
5. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhmes Ekonomike” ;
6. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste në Arshiva Teknike në Drejtorinë e Planifikimit e Kontrollit të Territorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit”.

Gjithashtu, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të shpallë të lira pozicionet e mësipërme të punës, për t'u plotësuar më tej në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me nevojat e institucionit sipas strukturës së ardhshme të Bashkisë Elbasan.

Përjashtim në këtë rast, bëhet për punonjëset, *****, e cila është liruar nga detyra me urdhrin nr. 911, datë 29.07.2016 dhe *****, e cila është liruar nga detyra me urdhrin nr. 1190, datë 27.11.2015, për arsye të plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë.

- Rastet e mosdeklarimit të statusit për shkak se, janë shkëputur marrëdhëniet e punës përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit

Gjatë procesit të verifikimit, konstatohet se, në **4 raste** nuk është bërë deklarimi i statusit të punësimit, pasi këta punonjës kanë shkëputur marrëdhëniet e punës për shkak të plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë, përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Specialist në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Urbanistike Rajoni nr.1 dhe nr. 2”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhimes Ekonomike”;
4. *****, në pozicionin e punës, “Specialiste Ndhimes Ekonomike Rajoni nr.3”.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014 ”, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Në këtë rast Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, ka vepruar në mbështetje të kërkesave të nenit 65, shkronja “c”, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku parashikohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, e në rastin konkret, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë.

- Rastet e mosdeklarimit të statusit për shkak se, punonjësit janë liruar nga shërbimi civil përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit

Gjatë procesit të verifikimit, konstatohet se, në **5 raste** nuk është bërë deklarimi i statusit të punësimit, pasi këta punonjës janë liruar nga shërbimi civil me dorëheqje, përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Investimeve në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve e Prokurimeve Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projektiveve e Prokurimeve”;

2. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Strehimit në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve e Prokurimeve Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projektimeve e Prokurimeve*”;
3. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist në Drejtorinë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Organizative*”;
4. *****, në pozicionin e punës “*Specialist në Sektorin e Kontrollit në Drejtorinë e Tatim Taksave* ”;
5. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave*”;

Nga verifikimi i këtyre rasteve, rezulton se në dosje ndodhen kërkesat e tyre për dorëheqje si dhe procedura e miratimit të dorëheqjes.

Aktet administrative që e materializojnë këtë procedurë, për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “*Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)*”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Në këtë rast Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, ka vepruar në mbështetje të kërkesave të nenit 66, shkronja “dh”, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku parashikohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, e në rastin konkret, kur nëpunësi jep dorëheqjen nga detyra.

- *Rastet e mosdeklarimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil*

Gjatë procesit të verifikimit, konstatohet se në **4 raste**, megjithëse pozicionet e punës bënin pjesë në shërbimin civil, nga ana e njësisë përgjegjëse, gabimisht nuk është finalizuar deklarimi i statusit të punësimit, lidhur me personat që kanë qenë të punësuar në këto pozicione pune.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist për Media*”, liruar me urdhrin nr. 279, datë 08.07.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. *****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjës në Sektorin e Vendosjes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, aktualisht në punë,
3. *****, në pozicionin e punës, “*Administrator Rajoni nr. 5*”, aktualisht në punë,
4. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Regjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, aktualisht në punë.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “*Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)* ”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë, si dhe pozicionet e tyre plotësojnë kriteret për të qenë pjesë e shërbimit civil, në përputhje me

përkufizimin e nenit 4, të ligjit për nëpunësin civil, ku parashikohet përkufizimi i nëpunësit civil, si dhe me aktet nënligjore që rregullojnë përshkrimin e punës, në pozicionet që trajtohen si pjesë e shërbimit civil.

Njësia përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë dhe në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte realizuar deklarinimin e statusit të punësimit për këto raste.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të kryer në institucion, rezulton se punonjësi, Osman Gjevori, i cili aktualisht është liruar nga detyra, nuk ka treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tij ligjore, në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tij, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, ky punonjës nuk ka treguar interes për të kërkuar të drejtat e tij, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, ky punonjës e ka humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ai nuk do të trajtohet më tej si nëpunës civil, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmërues të Komisionerit për këtë institucion.

Ky rast u trajtua në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

Ndërkohë, për 3 punonjësit e tjerë, të cilët aktualisht janë në punë rezulton se, ata nuk janë trajtuar sipas procedurës së ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, si në rastet e mosdeklarimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave” ;
2. *****, në pozicionin e punës, “Administrator Rajoni nr. 5” ;
3. *****, në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Regjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave”.

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për punonjësit e nominuar, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirimimit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së detyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet t'i trajtojë këta punonjës si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të tyre në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t'u njohë të drejtat që atyre ju takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

➤ **Rastet e deklarimit të statusit të punësimit, pa të drejtë**

Nga analiza e materialeve të verifikuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, konstatohet se në **15 raste**, nga ana e njësisë përgjegjëse, të Bashkisë Elbasan, nuk janë respektuar kërkesat ligjore gjatë procedurave të ndjekura për deklarimin e statusit të punësimit, sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe akteve nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij. Konkretisht, bëhet fjalë për këto raste:

- Rastet e deklarimit të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin, për shkak të afatit kohor të punësimit në pozicionin e shërbimit civil, si dhe aspekte të tjera të veprimeve të parregullta gjatë administrimit të shërbimit civil

Gjatë procesit të verifikimit, konstatohet se në **8 raste**, në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, ishin emëruar punonjës, të cilët ishin të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë më pak se një vit dhe në kundërshtim me ligjin, të cilët janë deklaruar si nëpunës civilë, si dhe aspekte të tjera të administrimit jo korrekt të shërbimit civil. Bëhet fjalë për punonjësit:

1. ***** , aktualisht në pozicionin e punës, "Drejtores në Drejtorinë e Administratës e Burimeve Njerëzore". Kjo punonjëse, rezultoi të ketë filluar punë në këtë institucion, me urdhrin nr. 223, datë 04.04.2008, në pozicionin e punës, "Specialiste e Ndihmës Ekonomike" dhe me vendimin nr. 521/1, datë 28.12.2009, është konfirmuar si nëpunëse civile, sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil". Me urdhrin nr. 546, datë 23.12.2013, ka kaluar në pozicionin e punës, "Drejtores në Drejtorinë e Administratës e Burimeve Njerëzore", në kundërshtim me procedurat e parashikuara ligjore. Konstatohet se, me aktin nr. 278, datë 13.06.2014, është deklaruar statusi i punësimit si "nëpunës civil", për këtë punonjëse, duke mos e specifikuar pozicionin e punës dhe kategorinë e nëpunësisë civile.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësës, rezultoi se, njësisë përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjëse, me pozicionin ku e ka gjetur fillimi i efekteve të ligjit për nëpunësin civil, ka filluar në datën 23.12.2013. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, (data 26.02.2014), ajo kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune, e për këtë arsye duhet të deklarohet nëpunëse civile në periudhë prove.

Gjithashtu, rezulton se në aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “*nëpunës civil*”, me nr.278, datë 13.06.2014, nuk është shprehur kategoria e pozicionit si dhe pozicioni i punës, të cilën kjo nëpunëse ka përfitur statusin.

Në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësja ******, me urdhrin nr.1174/2, datë 18.12.2015, duke mos kryer asnjë procedurë ligjore dhe pa asnjë argument të bazuar në ligj, e ka ulur në detyrë këtë punonjëse, duke e emëruar “*Specialiste e Ndihmës Ekonomike*”, duke përcaktuar si afat kohor, kushtin e miratimit të strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Në këtë rast, nuk ndodhemi në asnjë prej kushteve ligjore të uljes në detyrë, si masë disiplinore, apo të uljes në detyrë për arsye ristrukturimi, por ndodhemi përpara një akti absolutisht të pavlefshëm, i cili duhet të revokohet.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, e cila evidentohet në disa institute të ligjit, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin administrativ nr. 278 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen ******, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë prove*”, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, *është më pak se 1 vit*. Po kështu, të plotësojë këtë akt administrativ, duke përcaktuar kategorinë e pozicionit të punës në nivelin e mesëm drejtues, në pozicionin konkret “*Drejtorë në Drejtorinë e Administratës e Burimeve Njerëzore*”.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej, të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsytimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).
- Të anulohet urdhrin nr. 1174/2, datë 18.12.2015, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan dhe të rregullojë pasojat që kanë ardhur në dëm të punonjësës, për shkak të këtij akti absolutisht të pavlefshëm.

2. ******, aktualisht në pozicionin e punës, “*Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse*”, ka filluar punë në institucion me urdhrin nr. 430, datë 31.10.2011, në pozicionin e punës, “*Drejtor në Drejtorinë e Shërbimit Urban*”. Me urdhrin nr. 120, datë 21.03.2013, pa kryer asnjë procedurë ligjore, ka kaluar në pozicionin e

punës, “*Drejtor i Përgjithshëm*”, në Drejtorinë Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse. Konstatohet se ka dalë akti i deklarimit të statusit të punësimit si “*nëpunës civil*”, me nr. 277, datë 13.06.2014, i njësisë përgjegjëse, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Përgjithshëm*”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjës në këtë pozicion, ka filluar në datën **21.03.2013**. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), ai kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 277 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse*”, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në të njëjtin pozicion pune, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA)).

3. *****, aktualisht në pozicionin e punës, “*Drejtor në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, ka filluar punë me vendimin nr. 411/1, datë 16.07.2010, sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, në pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Kontrollit dhe Vjeljes së Detyrimeve*” dhe me vendimin nr. 431/2, datë 17.09.2008, të eprorit, është konfirmuar si nëpunës civil. Me urdhrin nr. 118, datë 21.03.2013, rezulton se është emëruar në pozicionin “*Drejtor në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, duke mos kryer asnjë procedurë ligjore të ngritjes në detyrë. Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “*nëpunës civil*”, me nr. 276, datë 13.06.2014.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësit rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast,

pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjës, me pozicionin ku është deklaruar statusi i punësimit, ka filluar në datën **21.03.2013**.

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), punonjësi kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 276 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin *****, në pozicionin “Drejtor në Drejtorinë e Tatim Taksave”, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPА).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (*të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPА)*).

4. *****, aktualisht në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave”, ka filluar punë në institucion në datën 03.07.2009, si “Specialist i Auditit” dhe është konfirmuar si nëpunës civil me vendimin nr.152, datë 30.04.2009, sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në këtë pozicion pune. Me urdhrin nr. 119, datë 21.03.2013, ka kaluar, duke mos u respektuar procedurat ligjore, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave”. Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si “nëpunës civil”, me nr. 281, datë 13.06.2014.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjës ka filluar në datën **21.03.2013**. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), ai kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune.

Në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësi *****, me urdhrin nr. 791, datë 01.11.2014, është emëruar në pozicionin e punës, “Drejtor i Auditit”, nëpërmjet procedurës

së ngritjes në detyrë (*moment, i cili do të trajtohet në vijim të materialit, në rubrikën, "Rekrutimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë"*).

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 281 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin ***** në pozicionin e punës, "*Përgjegjës i Sektorit të Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave*", duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga "*nëpunës civil*", në "*nëpunës civil në periudhë prove*", në të njëjtin pozicion pune, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, *është më pak se 1 vit*.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPА).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (*të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPА)*).

5. ***** aktualisht në pozicionin e punës, "*Specialist në Sektorin e Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave*", ka filluar punë me urdhrin nr. 50, datë 13.02.2014, në këtë pozicion pune.

Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit si "*nëpunës civil*", me nr. 338, datë 19.06.2014.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjës ka filluar në datën **13.02.2014**. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), ai kishte *më pak se 1 vit* në atë pozicion pune.

Në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësi ***** me urdhrin nr. 264, datë 29.02.2016 ka kaluar në pozicionin e punës, "*Specialist në Sektorin e Terrenit në Agjensinë e Tatimeve e Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së Taksave*", pa zbatuar asnjë procedurë ligjore në këtë rast, duke përcaktuar si afat kohor miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 338 prot., datë 19.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin ***** në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “*nëpunës civil*”, në “*nëpunës civil në periudhë prove*”, në të njëjtin pozicion pune, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).

6. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, ka filluar punë me aktin nr. 287, datë 11.10.2010 dhe është konfirmuar si nëpunës civil në këtë pozicion pune, me aktin nr. 582, datë 31.12.2013, sipas procedurave të ligjit nr. 8549/1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”. Me urdhrin nr. 101, datë 06.03.2014, është emëruar “*Përgjegjës në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, pra, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil. Njësi përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit si “*nëpunës civil*” me nr. 298, datë 19.06.2014, në pozicionin e kategorisë së ulët drejtuese, si *Përgjegjës Sektori*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit rezultoi se, njësi përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjëse në pozicionin e punës, “*Përgjegjës në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave*”, ka filluar në datën 06.03.2014.

Në këto kushte, deklarimi i statusit të punësimit në rastin konkret duhet të bëhet në bazë të gjendjes faktike të punësimit në datën 26.02.2014, domethënë, të pozicionit të punës që ka pasur realisht nëpunësi ditën e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, konkretisht në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave*”. Ky moment duhet të përbëjë kriterin

bazë të vlerësimit, për të arritur në konkluzionin se, në cilin pozicion pune duhet deklaruar statusi i punësimit, për punonjësin në fjalë.

Gjithashtu, në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësja ******, me urdhrin nr.240, datë 29.02.2016, kalon në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vlerësimit në Agjensinë e Tatimeve e Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 298 prot., datë 19.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit si “nëpunësit civil” për nëpunësen ******, në pozicionin e punës, “Përgjegjës në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave”.
- Të deklarohet statusin e punësimit si “nëpunës civil”, i konfirmuar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave”, për arsye se, kjo nëpunëse këtë pozicion pune ka patur realisht, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).
- Të anulohet urdhrin nr. 101, datë 06.03.2014, të Kryetarit të Bashkisë, me të cilin është emëruar në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave”, sepse është vepruar pasi kishin filluar efektet juridike të ligjit për nëpunësin civil, në kundërshtim me kërkesat e tij, e për të njëjtën arsye, të anulohet urdhrin nr. 240, datë 29.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë, me të cilin nëpunësja ka kaluar në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vlerësimit në Agjensinë e Tatimeve e Tarifave Vendore dhe Mbledhjes së të Ardhurave”, si dhe të sistemojë punonjësen në kategorinë e pozicionit të punës, që i takon për shkak të deklarimit të statusit të punësimit.
- Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Vendosijes së Tatimeve në Drejtorinë e Tatim Taksave” duhet të shpallet i lirë, për t’u plotësuar më tej, në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Elbasan.

7. ******, aktualisht në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Programeve Sociale dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Drejtorinë e Kujdesit Social”, ka filluar punë në institucion me aktin nr. 58, datë 10.10.2006, në pozicionin e punës, “Specialiste në Seksionin e Mbrojtjes së Fëmijëve” dhe është konfirmuar me vendimin nr.538, datë 11.12.2007, sipas procedurave të ligjit nr. 8485/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në këtë pozicion pune. Me urdhrin nr. 164, datë 13.05.2013, është emëruar në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Programeve Sociale dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Drejtorinë e Kujdesit Social”. Njësia përgjegjëse e ka deklaruar statusin e punësimit si “nëpunësit civil”, me aktin nr. 288, datë 13.06.2014, në kategorinë e nivelit të ulët drejtues, si Përgjegjës Sektori.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësës, rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjëse ka filluar në datën 13.05.2013. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), ajo kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 288 prot., datë 13.06.2014, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësen *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Programeve Sociale dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në Drejtorinë e Kujdesit Social”, duke e ndryshuar pozicionimin e saj në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.
- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
- Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësja gjatë periudhës së provës.
- Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).
- Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, (të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA).

8. *****, në pozicionin e punës, “Administrator Rajoni nr. 5”, ka filluar punë me urdhrin nr. 205, datë 02.07.2013, në këtë pozicion pune. Njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si “nëpunës civil”, me nr. 664, datë 02.09.2015, në pozicionin e administratorit të rajonit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësit rezultoi se, njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjës ka filluar në datën 02.07.2013. Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2016), ai kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin nr. 664, datë 02.09.2015, për deklarimin e statusit të punësimit për nëpunësin *****, në pozicionin “Administrator Rajoni nr. 5”, duke e ndryshuar pozicionimin e tij në raport me shërbimin civil, nga “nëpunës civil”, në “nëpunës civil në periudhë prove”, në të njëjtin pozicion pune, për arsye se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014), rezulton se kohëzgjatja e periudhës së punësimit, është më pak se 1 vit.

- Të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe udhëzimeve të Departamentit të Administratës Publike.
 - Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.
 - Të krijohet mundësia për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm dhe më tej të administrohet rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPА).
 - Të nxjerrë vendimin e arsyetuar në përfundim të periudhës së provës. Gjatë arsyetimit të vendimit të konfirmimit, duke përfshirë evidentimin e bazës ligjore ku mbështetet procesi, duhet të argumentohet në mënyrë të qartë edhe përmbajtja e procesit, që përfshin datën e fillimit të periudhës së provës, plotësimin e detyrimeve të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, *(të përmendet dokumenti i përfundimit të trajnimit të detyrueshëm dhe rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPА).*
- *Rastet e deklарimit të statusit të punësimit në kundërshtim me ligjin për shkak të mospërputhjes së edukimit arsimor si dhe të kualifikimit, me kërkesat e vendit të punës*

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se në **7 raste**, në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, ishin emëruar punonjës të cilët nuk plotësonin kërkesat e vendit të punës me kualifikimin e tyre. Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, aktualisht në pozicionin e punës, *“Përgjegjës Sektori, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”*. Ky punonjës ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr. 202, datë 16.07.2007, si *“Përgjegjës Sektori në Sektorin e Informacionit”* dhe më tej, me urdhrin nr. 56, datë 08.02.2008, të Kryetarit të Bashkisë, rezulton të ketë kaluar në pozicionin e punës, *“Specialist i Protokollit”*. Rezulton se në pozicionin aktual të punës, ai ka kaluar me urdhrin nr. 8, datë 10.01.2012, të Kryetarit të Bashkisë.

Njësia përgjegjëse, me aktin nr. 439, datë 17.06.2014, ka deklaruar statusin e tij të punësimit si *“nëpunës civil”*, në kategorinë e ulët drejtuese, si *Përgjegjës Sektori*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësit, në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, ai zotëronte diplomën DIND, Fakulteti Ekonomik, Dega Finance Kontabilitet, Universiteti *“Aleksandër Xhuvani”*, Elbasan.

Ndërkohë, sipas kritereve të parashikuara në Lidhjen nr. 3, pika 24, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015, niveli arsimor për pozicionin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, arsimimi i kërkuar duhet të jetë sipas specifikës së pozicionit të punës në informatikë, shkenca kompjuterike dhe të lidhura me to.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se ky punonjës nuk përmbush kërkesat e ligjit, për të mbajtur pozicionin në të cilin punon aktualisht.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 439, datë 17.06.2014, pasi punonjësi *****, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi *****, nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.
- Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

2. *****, aktualisht në pozicionin e punës, “Specialist, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, ka filluar punë me urdhrin nr. 26, datë 10.01.2012, të Kryetarit të Bashkisë në këtë pozicion pune.

Njësia përgjegjëse, me aktin nr. 452, datë 17.07.2014, ka deklaruar statusin e punësimit si “nëpunës civil”, për këtë punonjës, në të njëjtin pozicion pune.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësit, në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësi ***** zotëronte diplomën DIND, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Dega Frëngjisht, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan dhe Diplomë “Bachelor” në IT, të datës 16.07.2014.

Ndërkohë, sipas kriterëve të parashikuara në Lidhjen nr. 3, pika 24, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimit e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015, niveli arsimor për pozicionin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, arsimimi i kërkuar duhet të jetë sipas specifikës së pozicionit të punës në informatikë, shkencë kompjuterike dhe të lidhura me to.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se ky punonjës nuk përmbushte kërkesat e ligjit, për t’u deklaruar si nëpunës civil në këtë pozicion pune, pasi në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, në datën 26.02.2014, ai nuk e kishte këtë edukim arsimor. Deklarimi i statusit të punësimit, është i lidhur ngushtë me plotësimin e kriterëve në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit, pasi e drejta e statusit të nëpunësit civil në këtë rast, përfitohet për shkak të ligjit.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 452, datë 17.07.2014, pasi punonjësi *****; në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi *****; nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”.
- Pozicioni i punës, “Specialist, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social” duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

3. *****; në pozicionin e punës, “Specialist, në Sektorin e IT-së, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, ka filluar punë me urdhrin nr. 38, datë **10.02.2014**, dhe njësia përgjegjëse, me aktin nr. 51, datë 17.07.2014, i ka deklaruar statusin e punësimit si “nëpunës civil në periudhë prove”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punës në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësi ***** zotëronte diplomën DIND, Fakulteti Shkencave Sociale, Dega Histori Gjeografi, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan. Sipas kriterëve të parashikuara në Lidhjen nr. 3, pika 24, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015, niveli arsimor për pozicionin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, arsimimi i kërkuar duhet të jetë sipas specifikës së pozicionit të punës në informatikë, shkenca kompjuterike dhe të lidhura me to.

Nga sa më sipër, për të njëjtat arsye të trajtuara edhe në rastin më sipër, arrihet në përfundimin se ky punonjës nuk përmbush kërkesat e ligjit, për të mbajtur pozicionin në të cilin punon aktualisht.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 51, datë 17.07.2014, pasi punonjësi *****; në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, punonjësi *****; nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

- Pozicioni i punës, *“Specialist në Sektorin e IT-së në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Drejtoria e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”* duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

4. ***** në pozicionin e punës, *“Përgjegjese Sektori në Sektorin e Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”*, ka filluar punë në këtë institucion me urdhrin nr.324, datë 19.07.2007, të Kryetarit të Bashkisë, si *“Specialiste në Sektorin e Hartimit të Projekteve Ekonomike”*.

Njësia përgjegjëse, me aktin nr. 285, datë 13.06.2014, ka deklaruar statusin e punësimit si *“nëpunës civil”*, në këtë pozicion pune.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale të punonjësës, në momentin e mbikëqyrjes, rezultoi se, punonjësja ***** me urdhrin nr.727, datë 13.05.2016, ka kaluar *“Përgjegjese Sektori në Sektorin e Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”*, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Gjithashtu, u konstatua se, punonjësja ***** zotëronte diplomën DIND, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dega Gjermanisht dhe *“Bachelor”*, në Administrim Biznesi, Universiteti *“Aleksandër Xhuvani”*, Elbasan. Sipas kriterëve të parashikuara në Lidhjen nr. 3, kategoria III, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014 *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015, niveli arsimor për pozicionin e specialistëve të statistikave, arsimimi i kërkuar duhet të jetë sipas specifikës së pozicionit të punës në shkenca ekonomike dhe të lidhura me to.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se kjo punonjëse nuk përmbush kërkesat e ligjit, për të mbajtur pozicionin në të cilin punon aktualisht, pasi në momentin e fillimit të efekteve të tij, ajo nuk kishte edukimin arsimor përkatës.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 285, datë 13.06.2014, pasi ***** në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, sepse nuk zotëronte diplomën *“Master shkencor”* në shkenca ekonomike.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të punësimit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse, duke evidentuar faktin se, ajo nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr.116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

- Të anulohet urdhrin nr. 727, datë 13.05.2016, të Kryetarit të Bashkisë, me anë të së cilit kjo nëpunëse ka kaluar në pozicionin e punës “Përgjegjëse Sektori në Sektorin e Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, pasi ky akt ka dalë në kundërshtim me procedurat për lëvizjen paralele, ose ngritjen në detyrë, parashikuar nga nenet 25 dhe 26, i ligjit për nëpunësin civil.
- Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

5. ******, në pozicionin e punës, “Specialiste, në Sektorin e Statistikave, në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”, ka filluar punë në këtë institucion, me urdhrin nr. 323, datë 19.07.2007, në pozicionin e punës, “Specialiste në Sektorin e Informacionit” dhe me urdhrin nr. 285, datë 01.03.2012, është emëruar në pozicionin e punës “Specialiste në Sektorin e Statistikave në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”. Rezulton se, njësia përgjegjëse, me aktin nr. 286, datë 13.06.2014, ka deklaruar statusin e punësimit si “nëpunës civil”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësja ******, zotëronte diplomën DIND, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, dega Frëngjisht dhe “Bachelor” në Administrim Biznesi, Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Sipas kriterëve të parashikuara në Lidhjen nr. 3, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, i ndryshuar, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, niveli arsimor për pozicionin e specialistëve të statistikave, arsimimi i kërkuar duhet të jetë sipas specifikës së pozicionit të punës në shkencat ekonomike dhe të lidhura me to.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se kjo punonjëse nuk i përmbush kërkesat e ligjit, për të mbajtur pozicionin në të cilin punon aktualisht.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 286, datë 13.06.2014, pasi punonjësja ******, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk e plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse, duke evidentuar faktin se, ajo nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

- Pozicioni i punës, *“Specialist në Sektorin e Statistikave në Drejtorinë e Politikave të Zhvillimit Ekonomik në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik Strategjik e Social”*, duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

6. ***** në pozicionin e punës, *“Drejtor i Kujdesit Social”*, ka filluar punën në këtë institucion, me urdhrin nr. 302, datë 16.07.2007, si *“Drejtor i Sherbimit Social e Shendetit Publik”* dhe me urdhrin nr. 402, datë 22.09.2011, është emëruar në pozicionin e punës, *“Përgjegjës Sektori në Sektorin e Ndhmës Ekonomike në Drejtorinë e Kujdesit Social”*.

Rezulton se, nga ana e njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 332, datë 19.06.2014, është deklaruar statusi i punësimit si *“nëpunës civil”*.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, në momentin e mbikëqyrjes rezultoi se, punonjësi ***** me urdhrin nr. 172, datë 23.02.2016, është emëruar në pozicionin e punës *“Drejtor i Kujdesit Social”*, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Gjithashtu, u konstatua se ky punonjës, zotëronte diplomë të Shkollës së Lartë të Oficerëve, niveli 3 vjeçar. Sipas kriterëve të parashikuara në Lidhjen 2, kategoria III, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, niveli arsimor për kategorinë *“Përgjegjës/Drejtor”*, është *Diplomë e integruar e nivelit të dytë (master shkencor)*.

Nga sa më sipër, arrijmë në përfundimin se ky punonjës nuk përmbush kërkesat e ligjit, për të mbajtur pozicionin e punës në të cilin punon aktualisht, gjithashtu edhe në pozicionin e punës *“Përgjegjës Sektori në Sektorin e Ndhmës Ekonomike në Drejtorinë e Kujdesit Social”*.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 332, datë 19.06.2014, pasi ***** në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, sepse nuk zotëronte diplomën *“Master shkencor”*.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës, duke evidentuar faktin se, ai nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”*, ndryshuar me VKM nr.532, datë 06.08.2014.
- Pozicioni i punës, *“Drejtor i Kujdesit Social”*, duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

7. ***** në pozicionin e punës, *“Specialiste në Drejtorinë e Projektim Standartizimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projekteve e Prokurimeve”*, ka filluar punë me urdhrin nr. 166, datë 13.05.2013 në këtë pozicion pune. Rezulton se me aktin nr. 367, datë 02.07.2014, është deklaruar statusi i punësimit si *“nëpunës civil në periudhë prove”*, nga njësia përgjegjëse.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e personelit, në momentin e mbikëqyrjes u konstatua se, punonjësja ***** zotëronte diplomën “Bachelor”, Fakulteti Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Ndërtim, Universiteti i Tiranës. Gjithashtu, në dosje nuk ka as diplomë, as listë notash, por ka vetëm një vërtetim të lëshuar nga Fakulteti me nr.1171, datë 29.10.2013.

Sipas kriterëve të parashikuara në Lidhjen 2, kategoria III, të VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, niveli arsimor për kategorinë Specialist (kategoria e pagës III-b) është Diplomë e integruar e nivelit të parë (master profesional).

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se kjo punonjëse nuk përmbush kërkesat e ligjit, për të mbajtur pozicionin në të cilin punon aktualisht.

Konkluzion: Në këtë rast, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të rregulluar situatën, duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

- Të anulohet aktin e deklarimit të statusit të punësimit, nr. 367, datë 02.07.2014, pasi punonjësja *****; në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nuk plotësonte kriterin e nivelit arsimor që kërkonte ky pozicion pune, pasi nuk zotëronte diplomën “Master Profesional”.
- Të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse, duke evidentuar shkakun se nuk i përmbush kriteret për të qenë nëpunës civil, në zbatim të pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr.532, datë 06.08.2014.
- Pozicioni i punës, “Specialist, në Drejtorinë e Projektim Standartizimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projektiveve e Prokurimeve”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

► **Situata e deklarimit të statusit të punësimit në Bashkinë Elbasan**

Nga analiza e dokumentacionit, përfundimisht rezulton se, në datën 26.02.2014, situata e deklarimit të statusit të punësimit në Bashkinë Elbasan, për **150 pozicione pune pjesë e shërbimit civil**, në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

- **Në 78 raste**, nga njësia përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit si nëpunës civilë, për punonjës të emëruar sipas kërkesave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 1** - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me konkurim sipas ligjit nr. 8549/1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe të konfirmuar si nëpunës civilë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

- Në 34 raste, nga njësia përgjegjëse është bërë deklarimi i statusit të punësimit, prej të cilave:
 - 20 raste kanë qenë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 2** – *Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), të cilët kishin më shumë se një vit, në pozicionin e punës, në Bashkinë Elbasan, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.*
 - 14 raste kanë qenë punonjës ekzistues të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit, pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 3** – *Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të cilët kishin më pak se një vit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.*
- Në 21 raste, nga njësia përgjegjëse nuk është realizuar procesi i deklarimit të statusit të punësimit, pasqyruar kjo, në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – *Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), që është pjesë përbërëse e këtij raporti, prej të cilave:*
 - 8 raste, për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor
 - 4 raste, për shkak se janë shkëputur marëdhëniet e punës përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit
 - 5 raste, për shkak se janë liruar nga shërbimi civil përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit
 - 4 raste, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil
- Në 15 raste, nga njësia përgjegjëse është deklaruar statusi i punësimit në kundërshtim me ligjin, prej të cilave:
 - 8 raste, për shkak të afatit kohor
 - 7 raste, për shkak të mospërputhjes së kualifikimit me kërkesat e vendit të punës
- Në 2 raste, pozicionet e punës, kanë qenë të lira, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).

II.a.4) Komuna Tregan, aktualisht Njësia Administrative Tregan

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 17, datë 30.01.2013, të Këshillit të Komunës Tregan. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **8 pozicione pune**, të cilat

pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë, nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, ç’ka vlerësohet normale, pasi komunat, para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësisë Administrative) Tregan, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se, nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **8 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 6 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Finance”, liruuar me urdhrin nr.1107, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Taksash”, liruuar me urdhrin e datës 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
3. *****, në pozicionin e punës, “Administratore”, liruuar me urdhrin nr. 929, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë,
4. *****, në pozicionin e punës, “Specialist Urbanistike”, liruuar me urdhrin nr.1108, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
5. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Shërbimesh”, liruuar me urdhrin nr.928, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
6. *****, në pozicionin e punës, “Agronom”, liruuar me urdhrin nr. 927, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësisë Administrative) Tregan, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarimin e statusit të punësimit për këto 6 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të kryer në institucion, rezulton se punonjësit, *****, *****, *****, ***** dhe *****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmërues të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

Ndërkohë, për 1 punonjëse, e cila aktualisht është në punë rezulton se, ajo nuk është trajtuar sipas procedurës së ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore edhe për punonjësit e ish-Komunës (*sot Njësisë Administrative*) Tregan, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, në rastet e mosdeklarimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Bëhet fjalë për punonjësen e mëposhtme:

1. *****, në pozicionin e punës, “Administratore”,

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për këtë punonjëse, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirimit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet ta trajtojë këtë punonjëse si nëpunëse civile, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të saj në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi

në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t'i njohë të drejtat që asaj i takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

- në 2 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, "Inspektor Pyjesh/Inspektor i Mjedisit dhe M.Lulishte",
2. *****, në pozicionin e punës, "Veteriner".

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se në këto 2 raste, edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku këta persona nuk ishin paguar si punonjës me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës "e", të nenit 21, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky i përcaktuar në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Tregan, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****, në pozicionin e punës, "Inspektor Pyjesh/Inspektor i Mjedisit dhe M.Lulishte",
2. *****, në pozicionin e punës, "Veteriner";

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

II.a.5) Komuna Shirgjan, aktualisht Njësia Administrative Shirgjan

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 43, datë 25.10.2013, të Këshillit të Komunës Shirgjan. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **9 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, ç`ka vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësia Administrative) Shirgjan, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **9 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 3 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Zyrës së Bujqësisë”, liruar me urdhrin e datës 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë.
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Ndhmës Ekonomike”, liruar me urdhrin nr. 936, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë.
3. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Urbanistike”, liruar me urdhrin nr.1080, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave

administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësisë Administrative) Shirgjan, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarimin e statusit të punësimit për këto 3 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion: Gjatë verifikimit të kryer në institucion Komisioneri konstaton se, punonjësit, *****, ***** dhe *****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmëruar të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

➤ në 4 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Buxheti/Tatim Taksave”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Mjedisi”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Veteriner”;

4. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Ndhmës Ekonomike”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se në këto 4 raste, edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku këta persona nuk ishin paguar si punonjës me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e” të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky i përcaktuar në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Shirgjan, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Buxheti/Tatim Taksave”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Mjedisi”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Veteriner”;
4. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Ndhmës Ekonomike”;

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

➤ në 1 rast, nuk ka dosje

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësen *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Financës”.

Në këto kushte, nuk mund të dalin të dhëna të tjera, pasi mungojnë aktet administrative në dosjen individuale të punonjësës.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për punonjësen *****, e punësuar në pozicionin e punës pjesë, e shërbimit civil pranë ish-Komunës

(sot Njesisë Administrative) Shirgjan, duhet që: së pari, të plotësojë dosjen individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendet e punës; së dyti, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë ose të refuzojë statusin e punësimit të saj dhe së treti, nëse punonjësja deklarohehet në kategorinë e nëpunësit civil, të trajtohet sipas ligjit nga Komisioni i Ristrukturimit.

- në **1** rast, pozicioni i punës, “Jurist” ka qenë i lirë në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).

II.a.6) Komuna Labinot-Mal, aktualisht Njësia Administrative Labinot-Mal

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 5, datë 24.02.2014 të Këshillit të Komunës Labinot-Mal. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **8 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, ç`ka vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njesisë Administrative) Labinot-Mal, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, arrihet në përfundimin se nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **8 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil**, mund të klasifikohen si më poshtë:

- në **2** raste, pozicioni i punës gabimisht nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****; në pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, liruar me urdhrin nr.1061, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

2. *****, në pozicionin e punës “Inspektor i Ndhmës Ekonomike” liruar me urdhrin nr.1078, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësisë Administrative) Labinot-Mal, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarin e statusit të punësimit për këto 2 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion: Gjatë verifikimit të kryer në institucion, Komisioneri konstaton se, punonjësit, ***** dhe *****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmëruar të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

- në 3 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Tatim/Taksash” ;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Tatim/Taksash” ;
3. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Menaxhimit të Pyjeve Komunale”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave konstatohet se në këto 3 raste, edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku këta persona nuk ishin paguar si punonjës me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e” të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky që përcaktohet në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Labinot-Mal, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Tatim/Taksash” ;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Tatim/Taksash” ;
3. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Menaxhimit të Pyjeve Komunale”;

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

- në 3 raste mungojne dosjet individuale të personelit.

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”,

2. ***** , në pozicionin e punës, “*Veteriner/Inspektor i Zyrës së Shërbimeve*”,
3. ***** , në pozicionin e punës, “*Inspektor i Ndhmës Ekonomike*”.

Në këto kushte, nuk mund të dalin të dhëna të tjera, pasi mungojnë aktet administrative në dosjet individuale të punonjësve.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për punonjësit ***** , ***** dhe ***** , të punësuar në pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil pranë ish-Komunës (Njësisë Administrative) Labinot-Mal, duhet që: së pari, të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimin të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendet e punës; së dyti, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë, ose të refuzojë statusin e punësimit të tyre dhe së treti, nëse punonjësit deklarohen në kategorinë e nëpunësit civil, të trajtohen sipas ligjit nga Komisioni i Ristrukturimit.

II.a.7) Komuna Zavalinë, aktualisht Njësia Administrative Zavalinë

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 5, datë 25.05.2013, të Këshillit të Komunës Zavalinë. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **5 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil.

Konkretisht, këto sipas argumenteve të identifikuar në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **5 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil**, mund të klasifikohen si më poshtë:

- në 2 raste, nga njësia përgjegjëse me të drejtë, është deklaruar statusi i punësimit.

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

1. ***** , në pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”,
2. ***** , në pozicionin e punës, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Nisur nga përmbajtja e pikës 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se të 2 rastet kanë qënë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit.

Nga këqyrja dhe analiza që i është bërë akteve të emërimit dhe momentit të fillimit të marrëdhënieve financiare, rezulton e vërtetuar se, në të gjitha këto raste, këta punonjës, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, kanë patur më shumë se një vit vjetërsi, në detyrën që mbanin në datën 26.02.2014.

Për këtë kategori nëpunësish, me të drejtë njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit, si "nëpunës civilë", nëpërmjet vendimeve përkatëse të nxjerra, në muajin prill 2014, të cilat janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 3** – "*Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, "Statusi i nëpunësit civil", të cilët kishin më pak se një vit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan*", që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njesisë Administrative) Zavalinë, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në rastet e përmendura më sipër, ka zbatuar drejt ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit si nëpunës civilë, pasi ata i përmbushin kushtet e parashikuara në dispozitën e nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij.

➤ në 3 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, "*Inspektor Buxheti, Kontrolli i Brendshëm Financiar/Magazinë*", liruar nga detyra me urdhrin nr. 728, datë 10.09.2015, për arsye të plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë,
2. *****, në pozicionin e punës, "*Përgjegjës i Zyrës së tatimeve dhe Shërbimeve*", liruar me urdhrin nr. 1091, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
3. *****, në pozicionin e punës, "*Punonjës i Zyrës së Pyjeve dhe Agronom*". liruar me urdhrin nr.1109, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c, e ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njesisë Administrative) Zavalinë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarimin e statusit të punësimit për këto 3 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Përjashtim në këtë rast, bëhet për punonjësen *****, e cila është liruar nga detyra me urdhrin nr. 728, datë 10.09.2015, për arsye të plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë.

Konkluzion: Gjatë verifikimit të kryer në institucion, Komisioneri konstaton se punonjësit, ***** dhe *****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmërues të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësi përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

II.a.8) Komuna Gjinar, aktualisht Njësia Administrative Gjinar

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 91, datë 15.03.2013 të Këshillit të Komunës Gjinar. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **8 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat nga njësi përgjegjëse pa të drejtë, nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës

26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (*sot Njesisë Administrative*) Gjinar, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **8 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 4 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. *****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Zyrës së Financës*”, liruar me urdhrin e datës 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektor i Tatim-Taksash*”, liruar me urdhrin e datës 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
3. *****, në pozicionin e punës, “*Agronom*”, liruar me urdhrin nr. 716, datë 10.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
4. *****, në pozicionin e punës, “*Punonjës (Specialist) për Ndhmën Ekonomike*” liruar me urdhrin nr. 942, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (*sot Njesisë Administrative*) Gjinar, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarin e statusit të punësimit për këto 4 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion: Gjatë verifikimit në institucion, Komisioneri konstaton se punonjësit, *****, *****, ***** dhe *****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmërues të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

- në 3 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, për shkak të specifikave të punës që kryhet në këtë vend pune, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Punonjës Kulture”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Urbanistike”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Punonjëse (Specialiste) për Mbrojtjen e Fëmijëve”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave konstatohet se, në këto 3 raste edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku këta persona nuk ishin paguar si punonjës me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e” të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky që përcaktohet në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e

nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Gjinar, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****; në pozicionin e punës, “*Punonjës Kulture*”;
2. *****; në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Urbanistike*”;
3. *****; në pozicionin e punës, “*Punonjëse (Specialiste) për Mbrojtjen e Fëmijëve*”;

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

- në **1** rast, pozicioni i punës, “*Inspektor i Mjedisit Kullotave Pyjeve*” ka qenë i lirë në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).

II.a.9) Komuna Bradashesh, aktualisht Njësia Administrative Bradashesh

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 3, datë 20.01.2014, të Këshillit të Komunës Bradashesh. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **14 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njesisë Administrative) Bradashesh, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **14 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 12 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse Administrate”, liruar me urdhrin nr.1029, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, liruar me urdhrin nr. 1058, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
3. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Tatim- Taksash”, liruar me urdhrin nr. 1051, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
4. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Shërbimeve Publike”, liruar me urdhrin nr.1030, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
5. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Bujqësie”, liruar me urdhrin nr. 1057, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
6. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Bujqësie/Kadastrë” (në librezë), liruar me urdhrin nr. 388, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
7. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektorit Arsimit, Shëndetësi, Kulturë”, liruar me urdhrin nr. 1032, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
8. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektorit të Financës”, liruar me urdhrin nr. 1042, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
9. *****, në pozicionin e punës, “Specialist për Sistemin e Vadijes”, liruar me urdhrin nr.1033, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
10. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Tatim-Taksash”, liruar me urdhrin nr.890, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
11. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Buxheti”, liruar me urdhrin nr.891, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë,
12. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor e Ndhmës Ekonomike”, liruar me urdhrin nr. 1054, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave

administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (*sot Njësisë Administrative*) Bradashesh, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarinimin e statusit të punësimit për këto **12** raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarinimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të kryer në institucion, rezulton se punonjësit, ****, ****, ****, ****, ****, ****, ****, **** dhe ****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmëruar të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

Ndërkohë, për **2** punonjësit e tjerë, të cilët aktualisht janë në punë rezulton se, ata nuk janë trajtuar sipas procedurës së ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore edhe për punonjësit e ish-Komunës (*sot Njësisë Administrative*) Bradashesh, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, në rastet e

mosdeklarimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit e mëposhtëm:

1. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektor Buxheti*”;
2. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektor e Ndhmës Ekonomike*”.

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për punonjësit e nominuar, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirimit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet t’i trajtojë këta punonjës si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të tyre në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t’u njohë të drejtat që atyre ju takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- në 2 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektor Pyjesh*”;
2. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektore Finance*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, në këto 2 raste, edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët *nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor*, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë.

Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku rezultoi se këta punonjës nuk ishin paguar, me kategorinë e arsimit të lartë, si dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e” të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky që përcaktohet në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.*

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Bradashesh, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit

nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Pyjesh”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektore Finance”;

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

II.a.10) Komuna Funar, aktualisht Njësia Administrative Funar

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 6, datë 21.02.2014, të Këshillit të Komunës Funar. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **3 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, grupi i punës konstatoi se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njesisë Administrative) Funar, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **3 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 1 rast pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjës in *****, në pozicionin e punës “Inspektor i Ndihmës Ekonomike”, liruar me urdhrin nr. 1109, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë.

Pozicioni i mësipërm i punës, nisur nga karakteristika dhe natyra e tij është pozicion pune, në të cilën nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, ky pozicion pune parashikohet edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku specifikohet klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje përkatëse rezulton se, punonjësi i mësipërm e përmbush kriterin e nivelit arsimor, pasi është me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësisë Administrative) Funar, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse ky punonjës duhet të ishte trajtuar si nëpunës civil. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarinimin e statusit të punësimit për këtë rast.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se ky punonjës, ndonëse nuk ka patur akt të deklarinimit të statusit të punësimit, kur është larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk është trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore edhe për punonjësit e ish-Komunës (sot Njësisë Administrative) Funar, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, në rastet e mosdeklarinimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Konkretisht bëhet fjalë për punonjës in e mëposhtëm:

1. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Ndihmës Ekonomike”.

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për punonjës in e nominuar, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirimit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet t'i trajtojë këta punonjës si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të tyre në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t'u njohë të drejtat që atyre ju takojnë si

nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- në 2 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Financës”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Buxheti”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave u konstatua se, në këto 2 raste edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku këta persona nuk ishin paguar si punonjës me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë, në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bën që marrëdhëniet e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësitë e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky që përcaktohet në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Funar, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Financës”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Buxheti”;

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësitë përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

II.a.11) Komuna Papër, aktualisht Njësia Administrative Papër

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së

miratuar me Vendimin nr. 39, datë 24.12.2013, të Këshillit të Komunës Papër. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **15 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njesisë Administrative) Papër, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **15 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 10 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil:

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, liruar me urdhrin nr. 1134, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Shërbimeve”, liruar me urdhrin nr. 933, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
3. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokave”, liruar me urdhrin nr.1033, datë 12.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
4. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Arsimit, Shëndetësisë, Kulturës, Rinisë Sporteve e Civile, Adresave Turizmit e Shërbimeve”, liruar me urdhrin nr. 1130, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
5. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Ndhmës Ekonomike/ Inspektor Social ShtetërorZyra e Shërbimit Social Shtetëror”, liruar me urdhrin nr. 961, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë,
6. *****, në pozicionin e punës, “Jurist/ Inspektor i Zyrës Juridike dhe Prokurimeve”, liruar me urdhrin nr. 647, datë 01.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë, (me dorëheqje),
7. *****, në pozicionin e punës, “Inspektore Tatim-Taksash”, liruar me urdhrin nr. 932, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,

8. ****, në pozicionin e punës, “*Inspektore Prot-Arkiv*”, liruar me urdhrin nr. 1120, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
9. ****, në pozicionin e punës, “*Inspektore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve*”, liruar me urdhrin nr. 698, datë 10.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
10. ****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse e Zyrës së Burimeve Njerëzore*”, liruar me urdhrin nr. 695, datë 10.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c, e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (*sot Njësia Administrative*) Papër, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarinimin e statusit të punësimit për këto **10** raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të kryer në institucion, rezulton se punonjësit, ****, ****, ****, ****, ****, ****, ****, **** dhe ****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmërues të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

Ndërkohë, për **1** punonjëse, e cila aktualisht është në punë rezulton se, ajo nuk është trajtuar sipas procedurës së ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore edhe për punonjësit e ish-Komunës (*sot Njësia Administrative*) Papër, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, në rastet e mosdeklarimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësen e mëposhtme:

1. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektor Ndhmës Ekonomike/ Inspektor Social Shtetëror Zyra e Shërbimit Social Shtetëror*”,

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për këtë punonjëse, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet ta trajtojë këtë punonjëse si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të saj në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t'i njohë të drejtat që asaj i takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- në 3 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektore Buxheti*”;
2. *****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Menaxhimit Projekteve dhe e Programimit të Investimeve*”;
3. *****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse e Zyrës Tatim-Taksave*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave konstatohet se, në këto **3** raste edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku këta persona nuk ishin paguar si punonjës me arsim të lartë.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky i përcaktuar në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Papër, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****, në pozicionin e punës, “Inspektore Buxheti”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Menaxhimit Projekteve dhe e Programimit të Investimeve”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Zyrës Tatim-Taksave”;

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

➤ në 1 rast, mungon dosja e personelit të punonjësit

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësin *****, në pozicionin e punës “Inspektor Shërbimit Pyjor, Zyra e Shërbimit Pyjor”.

Në këto kushte nuk mund të dalin të dhëna të tjera, pasi mungojnë aktet administrative në dosjen individuale të punonjësit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për punonjësin *****, i punësuar në pozicionin e punës, pjesë e shërbimit civil pranë ish-Komunës (Njësisë Administrative) Papër, duhet që: së pari, të plotësojë dosjen individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimin të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendin e punës; së dyti, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë ose të refuzojë statusin e punësimit të tij dhe së treti, nëse punonjësi deklarohet në kategorinë e nëpunësit civil, të trajtohet sipas ligjit nga Komisioni i Ristrukturimit.

- në 1 rast, pozicioni i punës, “Inspektor i Mjedisit Kullotave pyjeve” ka qenë i lirë në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).

II.a.12) Komuna Gjergjan, aktualisht Njësia Administrative Gjergjan

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 43, datë 14.02.2014, të Këshillit të Komunës Gjergjan. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **9 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësia Administrative) Gjergjan, që kishte funksionet e njësive përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësive së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **9 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil**, mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 3 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjëse e Zyrës së Financës”, liruuar me urdhrin nr. 965, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Tatim-Taksash”, liruuar me urdhrin nr.914, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
3. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Tatimesh”, liruuar me urdhrin nr.913, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave

administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot *Njësisë Administrative*) Gjergjan, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësi përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarimin e statusit të punësimit për këto 3 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të kryer në institucion, rezulton se punonjësit, ***** dhe ***** të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmëruar të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësi përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

Ndërkohë, për 1 punonjëse, e cila aktualisht është në punë rezulton se, ajo nuk është trajtuar sipas procedurës së ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësi përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore edhe për punonjësit e ish-Komunës (sot *Njësisë Administrative*) Gjergjan, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, në rastet e mosdeklarimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësen e mëposhtme:

1. ***** , në pozicionin e punës, “*Inspektor Tatimesh*”.

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për këtë punonjëse, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet ta trajtojë këtë punonjëse si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të saj në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t'i njohë të drejtat që asaj i takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

- në 4 raste, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. ***** , në pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës*”;
2. ***** , në pozicionin e punës, “*Inspektor Kadastrë*”;
3. ***** , në pozicionin e punës, “*Inspektor Ambjenti/Pyjesh*”;
4. ***** , në pozicionin e punës, “*Veteriner*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave u konstatua se, në këto 4 raste edhe pse pozicionet e mësipërme të punës janë pjesë e shërbimit civil, janë emëruar punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin e nivelit arsimor, për pozicionet e punës ku ata janë emëruar, pasi, nuk kanë arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listë pagesa e muajit shkurt 2014, ku këta persona nuk ishin paguar si punonjës me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky i përcaktuar në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.*

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Gjergjan, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastet e punonjësve:

1. *****, në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Kadastrë”;
3. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor Ambjenti/Pyjesh”;
4. *****, në pozicionin e punës, “Veteriner”;

kur punonjësit nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë dhe në kushtet kur, për këta punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, këta punonjës nuk e përmbushin kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

➤ në 2 raste, mungon dosja personale

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “P/Ndihmës Ekonomike”;
2. *****, në pozicionin e punës, “Inspektor i Arsimit dhe Kulturës”.

Në këto kushte nuk mund të dalin të dhëna të tjera, pasi mungojnë aktet administrative në dosjet individuale të punonjësve.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për punonjësit ***** dhe *****, e punësuar në pozicionin e punës pjesë e shërbimit civil pranë ish-Komunës (sot Njësisë Administrative) Gjergjan, duhet që: së pari, të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendet e punës; së dyti, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë ose të refuzojë statusin e punësimit të tyre dhe së treti, nëse punonjësit deklarohen në kategorinë e nëpunësit civil, të trajtohen sipas ligjit nga Komisioni i Ristrukturimit.

II.a.13) Komuna Shushicë, aktualisht Njësia Administrative Shushicë

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 4, datë 30.01.2014, të Këshillit të Komunës Shushicë. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka pasur **9 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot *Njësia Administrative*) Shushicë, që kishte funksionet e njësive përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësive së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **9 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil**, mund të klasifikohen si më poshtë:

➤ në 7 raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Finance*”, liruar me urdhrin nr.1142, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektor Buxheti*”, liruar me urdhrin nr. 703, datë 10.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
3. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektore Tatimesh*”, liruar me urdhrin nr. 599, datë 20.08.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
4. *****, në pozicionin e punës, “*Veteriner*”, liruar me urdhrin nr. 1143, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
5. *****, në pozicionin e punës, “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*”, liruar me urdhrin nr. 960, datë 16.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë,
6. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektore për Kujdesin Social të Fëmijëve*”, liruar me urdhrin e datës 10.09.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
7. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektor Pyjesh*”, liruar me urdhrin nr. 1144, datë 13.11.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (*sot Njësisë Administrative*) Shushicë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarinimin e statusit të punësimit për këto 7 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarinimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk janë trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të kryer në institucion, rezulton se punonjësit, *****, *****, *****, ***** dhe *****, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmërues të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

Ndërkohë, për 1 punonjës, e cili aktualisht është në punë rezulton se, ai nuk është trajtuar sipas procedurës së ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore edhe për punonjësit e ish-Komunës (*sot Njësisë Administrative*) Shushicë, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, në rastet e mosdeklarinimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësin e mëposhtëm:

1. *****, në pozicionin e punës, “Administrator i Ndihmës Ekonomike”,

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për këtë punonjës, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke ligjëruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirimit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet ta trajtojë këtë punonjës si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të tij në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t’i njohë të drejtat që atij i takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

- në 1 rast, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësi nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësen:

- ******, në pozicionin e punës “*Ekonomiste*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave konstatohet se, në këtë rast edhe pse pozicioni i mësipërm i punës është pjesë e shërbimit civil, është emëruar një punonjëse e cila nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor, për pozicionin e punës ku ajo është emëruar, pasi, nuk ka arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listëpagesa e muajit shkurt 2014, ku kjo punonjëse nuk ishte paguar si punonjëse me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky i përcaktuar në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Shushicë, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastin e punonjësës:

1. ******, në pozicionin e punës “*Ekonomiste*”;

kur punonjësja nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunëse civile dhe në kushtet kur, për këtë punonjëse aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, kjo punonjëse nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunëse civile, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

- në 1 rast, pozicioni i punës, “Inxhinier Ndërtimi/Jurist” ka qenë i lirë në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).

II.a.14) Komuna Gracen, aktualisht Njësia Administrative Gracen

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 1, datë 31.01.2014, të Këshillit të Komunës Gracen. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **4 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, grupi i punës konstatoi se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (*sot Njësia Administrative*) Gracen, që kishte funksionet e njësisë përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, *në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt*.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësisë së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **4 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

- në 2 raste, mungon dosja individuale e personelit

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****; në pozicionin e punës, “*Inspektor i Ndihmës Ekonomike*”,
2. *****; në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Financës*”.

Në këto kushte, nuk mund të dalin të dhëna të tjera, pasi mungojnë aktet administrative në dosjet individuale të punonjësve.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për punonjësit ***** dhe ***** , të punësuar në pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil pranë ish-Komunës (sot *Njësisë Administrative*) Gracen, duhet që: së pari, të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendet e punës; së dyti, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë ose të refuzojë statusin e punësimit të tyre dhe së treti, nëse punonjësit deklarohen në kategorinë e nëpunësit civil, të trajtohen sipas ligjit nga Komisioni i Ristrukturimit.

- në 1 rast, kur pozicioni i punës është pjesë e shërbimit civil, punonjësi nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësin ***** , në pozicionin e punës, “*Inspektor i Bujqësisë dhe Tatimeve*”, në këtë komunë.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave konstatohet se, në këtë rast edhe pse pozicioni i mësipërm i punës është pjesë e shërbimit civil, është emëruar punonjës i cili nuk plotëson kriterin e nivelit arsimor, për pozicionin e punës ku ai është emëruar, pasi, nuk ka arsimin e lartë. Konkretisht, kjo u verifikua nga listëpagesa e muajit shkurt 2014, ku ky person nuk ishte paguar si punonjës me arsim të lartë dhe nga mungesa e diplomës së shkollës së lartë në dosjen individuale të personelit.

Siç u tha edhe më lart, mosplotësimi i nivelit arsimor, në bazë të shkronjës “e”, të nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, bën që marrëdhënia e punësimit të konsiderohet e paligjshme dhe njësia e burimeve njerëzore, duhet të vendosë përfundimin e saj, detyrim ky i përcaktuar në pikën 7, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, ndryshuar me VKM nr. 532, datë 06.08.2014.

Edhe në këtë rast, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e Komunës Gracen, nuk ka vepruar drejt, sepse duhej të kishte nxjerrë aktin e refuzimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së tyre të punësimit, për mungesë të arsimit përkatës, në mbështetje të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe jo duke e trajtuar marrëdhënien e punës, sipas Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, për rastin e punonjësit:

1. ***** , në pozicionin e punës, “*Inspektor i Bujqësisë dhe Tatimeve*”; kur punonjësi nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil dhe në kushtet kur, për këtë punonjës aktualisht janë ndërprerë marrëdhëniet e punës, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan duhet të rregullojë gjendjen e paligjshmërisë, duke ndryshuar aktin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, ku bëhet fjalë për motivacionin dhe bazën ligjore, duke evidentuar faktin se, ky punonjës nuk e përmbush kriterin e nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe të bëhet pjesë e dosjes së personelit.

- në **1** rast, pozicioni i punës, “Përgjegjës Tatim-Taksash” ka qenë i lirë në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).

II.a.15) Komuna Labinot - Fushë, aktualisht Njësia Administrative Labinot -Fushë

Në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) kjo njësi ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 67, datë 15.02.2013, të Këshillit të Komunës Labinot-Fushë. Nga këqyrja e kësaj strukture, rezulton që në këtë moment, institucioni ka patur **5 pozicione pune**, të cilat pas fillimit të efekteve të ligjit të ri, plotësojnë kushtet për të qenë pjesë e shërbimit civil dhe për të cilat, nga njësia përgjegjëse pa të drejtë nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.

Aktet administrative për këto raste janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nëpunësit e punësuar në këto pozicione, kanë filluar marrëdhëniet e punës me akte emërimi të përkohshme ose me kontratë pune, gjë që vlerësohet normale, pasi komunat para datës 26.02.2014, nuk kanë qenë pjesë e fushës së veprimit të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”.

Nga verifikimi i mëtejshëm i të dhënave, konstatohet se, sektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (*sot Njësia Administrative*) Labinot-Fushë, që kishte funksionet e njësive përgjegjëse në lidhje me nxjerrjen e Aktit të Deklarimit të Statusit të Punësimit për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, *në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me këtë akt*.

Nga sa më sipër, konkludohet se nga ana e njësive së personelit **nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit.**

Konkretisht, sipas argumenteve të identifikuara në aktet përkatëse, arsyet e mosdeklarimit për **5 pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil,** mund të klasifikohen si më poshtë:

- në **3** raste, pozicioni i punës, gabimisht, nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit:

1. ******, në pozicionin e punës “Përgjegjës i Zyrës së Financës”, liruar me urdhrin nr.914, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë,
2. ******, në pozicionin e punës “Inspektor i Ndhmës Ekonomike”, liruar me urdhrin nr. 914, datë 13.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, por aktualisht është në punë,
3. ******, në pozicionin e punës “Përgjegjës Administrate”, liruar me urdhrin nr.973, datë 12.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë.

Pozicionet e mësipërme të punës, nisur nga karakteristikat dhe natyra e tyre janë pozicione pune, në të cilat nëpunësi civil duhet që të plotësojë kriteret që parashikon neni 4, pika c, e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku spikat ushtrimi i autoritetit administrativ, publik, në bazë të aftësisë dhe profesionalizimit dhe që marrin pjesë në formulimin dhe zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave procedurave administrative, sigurimin e ekzekutimit të tyre dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme administrative për zbatimin e tyre.

Gjithashtu, këto pozicione pune parashikohen edhe në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku specifikohen klasifikimi i pozicioneve të punës në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të administruara në dosjet përkatëse rezulton se, punonjësit e mësipërm e përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të lartë.

Spektori i burimeve njerëzore, pranë ish-Komunës (sot Njësia Administrative) Labinot-Fushë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse këta punonjës duhet të ishin trajtuar si nëpunës civilë. Në përputhje me pikën 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, njësia përgjegjëse duhet të kishte bërë deklarinimin e statusit të punësimit për këto 3 raste.

Mosveprimi në këtë rast, ka sjellë si pasojë faktin se këta punonjës, ndonëse nuk kanë patur akt të deklarimit të statusit të punësimit, kur janë larguar nga puna për shkak ristrukturimi, nuk është trajtuar sipas nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ndërkohë, gjatë verifikimit të kryer në institucion, rezulton se punonjësit, ***** dhe ******, të cilët aktualisht janë liruar nga detyra, nuk kanë treguar asnjë interes për të kërkuar të drejtën e tyre ligjore, në lidhje me deklarinimin e statusit të punësimit, në një prej kategorive si nëpunës civil, ose nëpunës civil në periudhë prove, sipas parashikimeve dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke braktisur në këtë mënyrë, me vullnetin e tyre, statusin e nëpunësit civil.

Po kështu, konstatohet se, edhe gjatë procesit të ristrukturimit, këta punonjës nuk kanë treguar interes për të kërkuar të drejtat e tyre, duke mos ushtruar ankim në gjykatën administrative, e cila, sipas ligjit për nëpunësin civil, është institucioni kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësit civil.

Në rrethanat sa më sipër, këta punonjës e kanë humbur statusin e nëpunësit civil, e për këtë arsye, ata nuk do të trajtohen më tej si nëpunës civilë, në këtë raport e po kështu edhe në vendimin paralajmëruar të Komisionerit për këtë institucion.

Këto raste u trajtuan në këtë material, për të vënë në dukje gabimet që ka lejuar njësia përgjegjëse në këtë institucion, gjatë zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, me qëllim që të mos përsëriten në të ardhmen.

Ndërkohë, për 1 punonjëse, e cila aktualisht është në punë rezulton se, ajo nuk është trajtuar sipas procedurës së ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, si struktura përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore edhe për punonjësit e ish-Komunës (*sot Njësisë Administrative*) Gjergjan, duhet të rregullojë pasojat e paligjshmërisë, në rastet e mosdeklarimit të statusit, kur pozicioni i punës, pa të drejtë nuk është konsideruar si pjesë e shërbimit civil, ashtu edhe gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësen e mëposhtme:

1. *****, në pozicionin e punës “*Inspektor i Ndhmës Ekonomike*”.

Për të rregulluar situatën e paligjshmërisë për këtë punonjëse, njësia përgjegjëse duhet të ndjekë hapat si më poshtë:

së pari, të bëjë verifikimin e kërkesave të posaçme për vendin e punës dhe të deklarojë statusin e punësimit, në zbatim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, duke ligjruar në këtë mënyrë trajtimin si nëpunës civil edhe në momentin e lirit nga shërbimi civil, për shkak ristrukturimi.

së dyti, Komisioni i Ristrukturimit duhet ta trajtojë këtë punonjëse si nëpunës civil, duke marrë parasysh mundësinë e sistemimit të saj në një pozicion të lirë, ose në rast se ndodhemi në kushtet e pakësimit të pozicionit të punës, duhet t’i njohë të drejtat që asaj i takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit të sipërpërmendur, si e drejta për të konkurruar si nëpunës civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

➤ **në 2 raste, nuk ka dosje**

Konkretisht bëhet fjalë për punonjësit:

1. *****, në pozicionin e punës “*Inspektor i Tatim-Taksash*”,
2. *****, në pozicionin e punës “*Agronom*”.

Në këto kushte, nuk mund të dalin të dhëna të tjera, pasi mungojnë aktet administrative në dosjet individuale të punonjësve.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për punonjësit ***** dhe *****, të punësuar në pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil pranë ish-Komunës (*sot Njësisë Administrative*) Labinot-Fushë, duhet që: **së pari**, të plotësojë dosjet individuale me të gjitha të dhënat sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që të kryejë verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe kërkesave të posaçme për vendet e punës; **së dyti**, pas përfundimit të verifikimit, të deklarojë, ose të refuzojë statusin e punësimit të tyre dhe **së treti**, nëse punonjësit deklarohen në kategorinë e nëpunësit civil, të trajtohen sipas ligjit nga Komisioni i Ristrukturimit.

▶ **Situata e përgjithshme e deklarimit të statusit të punësimit**

Në përfundim të verifikimit të të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me situatën e deklarimit të statusit të punësimit në Bashkinë Elbasan dhe në ish – Komunat, që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (*data 26.02.2014*) rezultojnë gjithsej **247** pozicione pune, pjesë e shërbimit civil.

Duke vlerësuar deklarin e statusit të punësimit nga ana e njërive përgjegjëse, sipas përcaktimeve të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, **247** rastet e deklarinimit ose jo të statusit të punësimit në Bashkinë Elbasan dhe në ish - Komunat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, ndahen në këtë mënyrë:

- **Në 78** raste, nga njëria përgjegjëse është bërë deklarinimi i statusit të punësimit si nëpunës civilë, për punonjës të emëruar sipas kërkesave të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, (pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 1** - “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjës të punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me konkurim sipas ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe të konfirmuar si nëpunës civilë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti).
- **Në 36** raste, nga njëria përgjegjëse është bërë deklarinimi i statusit të punësimit, prej të cilave:
 - **22** raste kanë qënë punonjës ekzistues, të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më tepër se 1 vit, (pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 2** – “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjës të punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), të cilët kishin më shumë se një vit, në pozicionin e punës, në Bashkinë Elbasan”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti).
 - **14** raste kanë qënë punonjës ekzistues të punësuar në të njëjtin vend pune, për një periudhë më pak se 1 vit, (pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 3** – “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjës të punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të cilët kishin më pak se një vit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti).
- **Në 111** raste, nga njëria përgjegjëse nuk është deklaruar statusi i punësimit, (pasqyruar kjo, në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjës të punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti), prej të cilave:
 - **33** raste për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor;
 - **4** raste për shkak se janë shkëputur marrëdhëniet e punës, përpara momentit të deklarinimit të statusit të punësimit;
 - **5** raste për shkak se janë liruar nga shërbimi civil përpara momentit të deklarinimit të statusit të punësimit;

- **58 raste** për shkak se pozicioni i punës nuk është konsideruar pjesë e shërbimit civil;
 - **11 raste** për shkak se mungon dosja e personelit.
- Në **15 raste**, nga njësia përgjegjëse është deklaruar statusi i punësimit në mënyrë të gabuar, prej të cilave:
- **8 raste**, për shkak të kalimit të afatit kohor;
 - **7 raste**, për shkak të mospërputhjes së kualifikimit me kërkesat e vendit të punës.
- në **7 raste**, janë pozicione pune që kanë qënë të lira në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014).

II.b) Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të paplotësuara (vende të lira)

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014)

- Në Bashkinë Elbasan ka pasur **2** pozicione pune të lira në shërbimin civil, konkretisht pozicionet e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Zhillimit dhe Kontrollit të Tokës” dhe “Specialist në Sektorin e Programeve Sociale dhe Njesisë së Mbrojtjes së Fëmijëve”.
- Në ish-Komunën (sot Njesisë Administrative) Shirgjan ka pasur **1** pozicion pune të lirë në shërbimin civil, konkretisht, pozicioni i punës, “Jurist”.
- Në ish-Komunën (sot Njesisë Administrative) Gjinar ka pasur **1** pozicion pune të lirë në shërbimin civil, konkretisht, pozicioni i punës, “Inspektor i Mjedisit dhe Kullotave, Pyjeve”.
- Në ish-Komunën (sot Njesisë Administrative) Papër ka pasur **1** pozicion pune të lirë në shërbimin civil, konkretisht, pozicioni i punës, “Inspektor Veterinarisë”.
- Në ish-Komunën (sot Njesisë Administrative) Shushicë ka pasur **1** pozicion pune të lirë në shërbimin civil, konkretisht, pozicioni i punës, “Inxhinier Ndërtimi/Jurist”.
- Në ish-Komunën (sot Njesisë Administrative) Gracen ka pasur **1** pozicion pune të lirë në shërbimin civil, konkretisht, pozicioni i punës, “Përgjegjës Tatim-Taksash”.

Ndërkohë, në njësitë administrative Tregan, Labinot-Mal, Zavalinë, Bradashesh, Funar, Gjergjan dhe Labinot- Fushë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (data 26.02.2014) nuk ka rezultuar asnjë pozicion pune i paplotësuar në shërbimin civil.

II.c) Procesi i deklarimit të statusit të punësimit në raport me afatet ligjore

Në bazë të, pikës 2, të Kreut II, të Vendimi nr. 116, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil

sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", njësitë përgjegjëse në institucionet e pushtetit vendor, duhej të përfundonin procesin e nxjerrjes së akteve të deklarimit të statusit jo më vonë se 120 (njëqind e njëzet) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, si dhe lejon të drejtën e shtyrjes së këtij afati një herë të vetme nga institucioni, për shkaqe të arsyeshme, jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë.

Konstatohet se njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan e ka kryer procesin e deklarimit të statusit të punësimit brenda afateve ligjore, konkretisht në muajin qershor 2014.

Në njësitë e pushtetit vendor që aktualisht përfshihen në juridiksionin e Bashkisë Elbasan, me përjashtim të ish-komunës (sot *Njësisë Administrative*) Zavalinë, e cila e ka kryer procesin e deklarimit të statusit të punësimit konkretisht, në muajin prill 2015, në **11** ish - komuna t tjera, konstatohet se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit, duke mos e përmbushur detyrimin ligjor për respektimin e afatit ligjor të përcaktuar për përfundimin e këtij procesi. Megjithatë, duhet theksuar që ky afat i vënë në dispozitat e Kreut IV, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, "Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë, që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", ndryshuar me VKM nr. 532 datë 06.08.2014, ka karakter organizativ dhe nuk passjell pavlefshmërinë e veprimeve apo mosveprimeve administrative për deklarimin e statusit të punësimit. Kjo vërejtje, shënohet në këtë material, për të tërhequr vëmendjen që në të ardhmen të tregohet kujdes në respektimin e afateve ligjore dhe të nxirret përgjegjësia personale.

III. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes u verifikua përbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se vetëm në Bashkinë Elbasan, janë evidentuar 14 nëpunës civilë kur nëpunësit civilë kanë qenë në periudhë prove, nga të cilët:

- **2** nëpunës civilë, janë të nivelit të lartë drejtues;
- **1** nëpunës civil, është i nivelit të mesëm drejtues;
- **1** nëpunës civil, është i nivelit të ulët drejtues;
- **10** nëpunës civilë, janë të kategorisë ekzekutive.

Ndërkohë, konstatohet se në 11 njësitë administrative, të organizuara më parë si: Komuna Tregan, Komuna Shirgjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Gjinar, Komuna Bradashesh, Komuna Funar, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Shushicë, Komuna Gracen dhe Komuna Labinot-Fushë, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nuk ishte aplikuar instituti i periudhës së provës në asnjë rast, pasi në këto subjekte nuk ishte kryer procesi i deklarimit të statusit, duke përjashtuar vetëm Komunën Zavalinë, ku ishte kryer procesi i deklarimit të statusit të punësimit, por nuk kishte asnjë nëpunës civil në periudhë prove.

Konstatohet se procedura e deklarimit të statusit të punësimit për **14 nëpunësit civilë** në periudhë prove, është zhvilluar në përputhje me pikën 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Kjo procedurë ka përfunduar dhe aktualisht është materializuar me aktet përkatëse të konfirmimit të punonjësit si nëpunës civil, në përputhje me nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ashtu si janë pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 3** – *Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të cilët kishin më pak se një vit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan, e cila është edhe pjesë përbërëse e këtij raporti.*

Njësia përgjegjëse, në rastin e aplikimit të periudhës së provës, duhet të veprojë duke u bazuar në dispozitat ligjore që rregullojnë këtë institut të ligjit, ku parashikohet se nëpunësi civil është i detyruar që të kryejë ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës së Administratës Publike (ASPA) dhe të ndjekë udhëzimet e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit ai është i vendosur. Ndërkohë, institucioni ka detyrimin që të përzgjedhë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të kryejë vlerësimin e rezultateve individuale në punë, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore dhe të shprehet me vendim në përfundim të periudhës së provës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u konstatua se në të **14 rastet**, ku ka përfunduar periudha e provës, është realizuar programi i trajnimit të detyrueshëm për nëpunësit civilë. Në dosjet e këtyre nëpunësve janë të administruara çertifikatat përkatëse të lëshuara nga Shkolla e Administratës Publike (ASPA) dhe vendimi i eprorit direkt, i shoqëruar me mendimin e nëpunësit civil më të vjetër.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, në rastet e evidentuara më sipër, ka vepruar drejt në lidhje me përbushjen e kërkesave ligjore të kryerjes së periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

III. Respektimi i kërkesave ligjore në hartimin e formularit të përshkrimit të punës

Një aspekt shumë i rëndësishëm, në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil, i cili ka lidhje me një sërë momentesh të administrimit të shërbimit civil, si rekrutimi, ristrukturimi, vlerësimi i punës, sistemi i karrierës, etj., është edhe procesi i hartimit të përshkrimit të punës, për pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil.

Fillimi i efeteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, e ngarkoi institucionin e mbikëqyrur, me detyrën e hartimit të përshkrimeve të pozicioneve të punës, brenda afatit të përcaktuar në këtë ligj, që ishte data 1 korrik 2014.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikuan formularët e përshkrimit të punës, për të parë se si janë zbatuar kërkesat e vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura” dhe udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Këto akte nënligjore, në përmbajtjen e tyre kanë përcaktuar procedurat e hollësishme që duhet të ndiqen për hartimin e përshkrimeve të punës, nëpunësit përgjegjës për hartimin e këtyre akteve, strukturën përgjegjëse për vlerësimin e bazueshmërisë së tyre në ligjin specifik dhe formatin e miratuar, organin që ka kompetencën për miratimin e tyre.

Gjatë procesit të verifikimit në institucionin e mbikëqyrtur u konstatua se, **nuk janë hartuar përshkrimet e punës, për të gjitha pozicionet e punës.** Përshkrimet e punës nuk janë hartuar sipas formatit standard të miratuar dhe nuk janë nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, eprori direkt dhe nga nëpunësi civil që punon në pozicionin për të cilin është hartuar përshkrimi i punës, sipas pikës 4.2.10, të Udhëzimit nr. 2, datë 07.04.2014 të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

Për sa më sipër, nisur nga rëndësia e madhe që ka hartimi i formularit të përshkrimit të punës sipas përcaktimeve ligjore dhe të akteve nënligjore që rregullojnë në mënyrë specifike procedurën që kërkohet të zbatohet në këtë rast, njësia përgjegjëse ta konsiderojë si detyrë me prioritet të lartë, në mënyrë që përshkrimet e punës të përgatiten dhe t'i paraprijnë procesit të ristrukturimit dhe më tej, procesit të konkurrimeve që do të zhvillohen në të ardhmen.

Ky proces vlerësohet me shumë rëndësi, për faktin se të gjithë elementët e përshkrimit të punës që trajtohen me hollësi në udhëzimet e përmendura më sipër, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në:

- a) organizimin e veprimtarisë institucionale në funksion të arritjes së misionit të institucionit;
- b) në përcaktimin e edukimit arsimor që duhet të ketë nëpunësi;
- c) në momente ristrukturimi;
- d) për të kontrolluar aktivitetin e nëpunësit;
- e) për vlerësimin e tij në fund të vitit kalendarik, si një detyrim ligjor, e në aspekte të tjera gjatë administrimit të shërbimit civil.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri kërkon që njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, të fillojë menjëherë punën për hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës, për pozicionet e shërbimit civil në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015 dhe Lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.

IV. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil

Në momentin e mbikëqyrjes, konstatohet se në këtë institucion, **nuk është hartuar plani vjetor, për pranimet e reja në shërbimin civil.**

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Elbasan, të përgatisë dhe të miratojë planin vjetor për pranimet e reja në shërbimin civil, sipas kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, për vitin në vijim.

V. Rekrutimi, lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, u verifikuan emërimet në pozicionet e shërbimit civil, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, të kryera pas datës 26.02.2014, që është data e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, deri në momentin e mbikëqyrjes.

➤ Gjatë verifikimit u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezultojnë **3 raste**, që përfshijnë kryerjen e procedurave ligjore të rekrutimeve, lëvizjeve paralele dhe të ngritjes në detyrë në pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil.

Konkretisht, bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

- ***** në pozicionin e punës, “Specialiste pranë Lagjja nr. 3”.

Nga verifikimet rezultoi se procedura e pranimit në shërbimin civil, është zhvilluar duke respektuar kërkesat e nenit 22, 23, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike, dhe VKM nr.143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drjetuese”, i shfuqizuar tashmë me VKM nr. 243, datë 18.03.2015 dhe me aktin nr. 390, datë 02.07.2014, është emëruar si “nëpunës civil në periudhë prove”, në kategorinë ekzekutive.

- ***** në pozicionin e punës, “Specialist Sekori Investimeve”.

Nga verifikimet rezultoi se, procedura e lëvizjes paralele, është zhvilluar duke respektuar kërkesat e nenit 25, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike, dhe VKM nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drjetuese”, shfuqizuar tashmë me VKM nr. 243, datë 18.03.2015 dhe me aktin nr. 103, datë 06.03.2014 është emëruar si “nëpunës civil”, në kategorinë ekzekutive.

- ***** në pozicionin e punës, “Drejtor i Auditit”.

Rasti në fjalë është analizuar në kapitullin e deklaramit të statusit të punësimit ku është konkluduar se njësia përgjegjëse nuk ka vepruar drejt në deklarimin e statusit të punësimit për këtë rast, duke e klasifikuar në kategorinë e nëpunësit civil, pasi marrëdhënia e punës për këtë punonjës ka filluar në datën **21.03.2013**. Pra, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, (*data 26.02.2014*), ai kishte më pak se 1 vit në atë pozicion pune.

Në këto rrethana, i është lënë detyrë njësisë përgjegjëse që të ndryshojë aktin e deklaramit të statusit të punësimit, duke e klasifikuar këtë punonjës, si nëpunës civil në periudhë prove, si dhe të ndjekë të gjitha hapat specifikë të përcaktuar për një nëpunës në periudhë prove.

Ndodhur në këto kushte, kur ky punonjës, ende nuk kishte përfituar statusin e nëpunësit civil, ai e kishte të ndaluar ligjërisht që të merrte pjesë në një procedurë ngritje në detyrë, ku kërkohet në mënyrë taksative të përmbushet kushti që më parë të jetë konfirmuar si nëpunës civil dhe më tej, të konkurrojë për pozicione më të larta, në hierarkinë administrative të shërbimit civil.

Bëhet fjalë për VKM nr. 143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, (*tashmë i shfuqizuar me VKM nr. 243, datë 18.03.2015*) Kreu VII, pika 2, germa “a”.

Për sa analizuam më lart, kjo procedurë konkurrimi është kryer në kundërshtim me kërkesat e ligjit, e për këtë arsye ajo duhet të anulohet dhe duhet të rifillojë nga faza e parë e konkurrimit, që përfshin verifikimin paraprak, nëse kandidatët i plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për vendin e shpallur për konkurrim, të përcaktuara nga ligji si dhe nga shpallja për konkurrim.

Fazat e konkurrimit, parashikohen në Kreun II, pika 3-10, Kreun III, pikat 1-7 dhe Kreun IV, pikat 1-23, të aktit nënligjor të përmendur më sipër, referuar në këto dispozita nga pika 3, e Kreut VII, “*Ngritja në detyrë*”, e po këtij akti.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të marrë masat për të anuluar të gjitha aktet administrative që kanë dalë, duke filluar që nga faza e parë të konkurrimit dhe të vazhdojë më tej procedurën e konkurrimit, për t’ a përmbyllur atë në përputhje me kërkesat ligjore.

Në përfundim, arrijmë në **konkluzionin** se, procedura për ngritjen në detyrë, ku ka fituar punonjësi *****, është zhvilluar duke mos respektuar kërkesat e nenit 26, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike, dhe VKM nr. 143, datë 12.03.2014, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, shfuqizuar tashmë me VKM nr. 243, datë 18.03.2015 dhe me aktin nr. 791, datë 01.11.2014, është emëruar si “nëpunës civil”, në kategorinë e mesme drejtuese.

Në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të përfundojë procedurat ligjore të konfirmimit të nëpunësit *****, i cili vetëm nëse arrin që të konfirmohet si nëpunës civil, është i lirë që të konkurrojë për procedurat e lëvizjes paralele, apo të ngritjes në detyrë.

Konkluzion: Në këtë rast Komisioneri vlerëson se, për të 2 rastet e mësipërme, për procedurat e rekrutimit, ku fitues janë shpallur punonjësit ***** dhe *****, njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Elbasan, ka vepruar drejt, duke respektuar kërkesat e nenit 22, 23, 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Udhëzimit nr. 4, datë 13.08.2014, të Departamentit të Administratës Publike, dhe VKM nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drjetuese”, shfuqizuar tashmë me VKM nr. 243, datë 18.03.2015.

Ndërsa, në rastin kur fitues është shpallur punonjësi **Gëzim Paja**, njësia përgjegjëse nuk ka respektuar kërkesat ligjore, e për këtë arsye për të rregulluar situatën e paligjshmërisë, duhet të drejtojë procesin për të kryer veprimet sipas këtij rendi pune:

- Të anulohet aktin e emërimit nr. 791, datë 01.11.2014, për emërimin e punonjësit ***** në pozicionin e punës, “Drejtor i Auditit”.
- Procedurat për lëvizjen paralele/ngritjen në detyrë, për pozicionin e punës, “Drejtor i Auditit”, duhet të rifillojnë nga e para, duke filluar me shpalljen e vendit të lirë në përputhje me kërkesat e ligjit dhe në koherencë me strukturën aktuale dhe nevojat e Bashkisë Elbasan.

➤ Raste të emërimeve në kundërshtim me ligjin, pas momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes si dhe gjatë periudhës së hartimit të raportit përfundimtar rezulton se, në Bashkinë Elbasan, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në **87 raste**, janë marrë në punë punonjës në pozicione pune të shërbimit civil, me akte emërimi ose kontrata të përkohshme, në kundërshtim me ligjin.

Bëhet fjalë për punonjësit e përmendur si më poshtë:

1. ***** në pozicionin e punës, “Specialist”, Zyra e Apelit të Taksave Vendore, emëruar me urdhrin nr. 81 prot., datë 29.01.2016.
2. ***** në pozicionin e punës, “Specialiste”, Drejtoria Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 146 prot., datë 17.02.2016.
3. ***** në pozicionin e punës, “Specialiste”, Drejtoria Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 433 prot., datë 15.03.2016.
4. ***** në pozicionin e punës, “Specialiste”, Drejtoria Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 478 prot., datë 23.06.2016.
5. ***** në pozicionin e punës, “Specialist”, Drejtoria Auditit të Brendshëm, emëruar me urdhrin nr. 562 prot., datë 07.04.2016.
6. ***** në pozicionin e punës, “Specialiste (Juriste)”, Sektori Njesisë së Prokurimeve, Drejtoria Prokurimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 398 prot., datë 11.05.2016.
7. ***** në pozicionin e punës, “Përgjegjës i Sektorit të Investimeve”, Drejtoria e Prokurimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 1214 prot., datë 15.12.2015.
8. ***** në pozicionin e punës, “Specialist”, Sektori Investimeve, Drejtoria Prokurimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 1230 prot., datë 21.12.2015.

9. ***** në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori Preventimit, Hartimit dhe Përcaktimit të Kritereve dhe Specifikimeve Teknike, Drejtoria Prokurimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 189 prot., datë 29.02.2016.
10. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori Preventimit, Hartimit dhe Përcaktimit të Kritereve dhe Specifikimeve Teknike Drejtoria Prokurimeve Publike, emëruar me urdhrin nr. 442 prot., datë 16.03.2016.
11. ***** në pozicionin e punës, “*Specialiste (Juriste)*”, Drejtoria e Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 695 prot., datë 11.05.2016.
12. ***** në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse e Sektorit të Informimit Qytetar*”, Drejtoria e Informacionit, emëruar me urdhrin nr. 117 prot., datë 09.03.2015.
13. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Planifikimit të Territorit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 741 prot., datë 16.09.2015.
14. ***** në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori i Infrastrukturës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 773 prot., datë 17.09.2015.
15. ***** në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse e Sektorit të Urbanistikës Ligjore dhe Lejet e Përdorimit*”, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, emëruar me urdhrin nr. 674 prot., datë 03.09.2015.
16. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Drejtoria e Projekteve dhe Shërbimeve Inxhinierike, emëruar me urdhrin nr. 644 prot., datë 11.09.2014.
17. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist (ing. Elektrik)*”, Drejtoria e Projekteve dhe Shërbimeve Inxhinierike, emëruar me urdhrin nr. 139 prot., datë 27.03.2014.
18. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Drejtoria e Projekteve dhe Shërbimeve Inxhinierike, emëruar me urdhrin nr. 176 prot., datë 23.02.2016.
19. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist (ing)*”, Drejtoria e Projekteve dhe Shërbimeve Inxhinierike, emëruar me urdhrin nr. 195 prot., datë 26.02.2016
20. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist (ing)*”, Drejtoria e Projekteve dhe Shërbimeve Inxhinierike, emëruar me urdhrin nr. 196 prot., datë 26.02.2016.
21. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Drejtoria e Projekteve dhe Shërbimeve Inxhinierike, emëruar me urdhrin nr. 734 prot., datë 16.05.2016.
22. ***** në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Sektori*”, Drejtoria Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave, emëruar me urdhrin nr. 975 prot., datë 22.10.2015.
23. ***** në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Drejtoria e Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave, emëruar me urdhrin nr. 970 prot., datë 22.10.2015.
24. ***** në pozicionin e punës, “*Jurist*”, Drejtoria e Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave, emëruar me urdhrin nr. 85 prot., datë 01.02.2016.
25. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist (Topograf)*”, Drejtoria e Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave, emëruar me urdhrin nr. 1200 prot., datë 07.12.2015.
26. ***** në pozicionin e punës, “*Specialist (Topograf)*”, Drejtoria e Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave, emëruar me urdhrin nr. 69 prot., datë 29.01.2016.

27. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist (Topograf)*”, Drejtoria e Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave, emëruar me urdhrin nr. 659 prot., datë 05.05.2016.
28. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist (Topograf)*”, Drejtoria e Detyrave të Projektim Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave, emëruar me urdhrin nr. 729 prot., datë 16.05.2016.
29. *****; në pozicionin e punës, “*Drejtores*”, Drejtoria e Administratës e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 175 prot., datë 23.02.2016.
30. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste (Juriste)*”, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria Administratës e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 465 prot., datë 23.03.2016.
31. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria Administratës e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 523 prot., datë 01.04.2016.
32. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Përfaqësimit në Gjykatë, Drejtoria Juridike, emëruar me urdhrin nr. 158 prot., datë 01.04.2015.
33. *****; në pozicionin e punës, “*Jurist*”, Sektori i Përfaqësimit në Gjykatë, Drejtoria Juridike emëruar me urdhrin nr. 87 prot., datë 01.02.2016.
34. *****; në pozicionin e punës, “*Jurist*”, Sektori i Përfaqësimit në Gjykatë, Drejtoria Juridike, emëruar me urdhrin nr. 513 prot., datë 31.03.2016.
35. *****; në pozicionin e punës, “*Jurist*”, Sektori i Përfaqësimit në Gjykatë, Drejtoria Juridike, emëruar me urdhrin nr. 759 prot., datë 25.05.2016.
36. *****; “*Specialiste Arkiv Protokoll*”, Drejtoria Juridike, emëruar me urdhrin nr. 597 prot., datë 19.08.2015.
37. *****; në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse e Sektorit të Zhvillimit dhe Karrierës*”, Drejtoria Administratës e Burimeve Njerëzore, emëruar me urdhrin nr. 149 prot., datë 17.02.2016.
38. *****; në pozicionin e punës, “*Drejtor*”, Drejtoria e Koordinimit me Njesitë Administrative, emëruar me urdhrin nr. 546 prot., datë 07.08.2015.
39. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Drejtoria e Koordinimit me Njesitë Administrative, emëruar me urdhrin nr. 560 prot., datë 10.08.2015.
40. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Drejtoria e Koordinimit me Njesitë Administrative, emëruar me urdhrin nr. 685 prot., datë 09.09.2015.
41. *****; në pozicionin e punës, “*Drejtores*”, Drejtoria e Financës emëruar me urdhrin nr. 545 prot., datë 12.08.2015.
42. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori i Kontrollit Financiar, Drejtoria e Financës nr. 248 prot., datë 29.02.2016.
43. *****; në pozicionin e punës “*Specialist-Inventarizues*”, Drejtoria e Financës, emëruar me urdhrin nr. 827 prot., datë 05.10.2015.
44. *****; në pozicionin e punës, “*Drejtores*”, Drejtoria e Aseteve, Pronave e Strehimit, emëruar me urdhrin nr. 361 prot., datë 07.03.2016.
45. *****; në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse i Sektorit të Strehimit*”, Drejtoria e Aseteve, Pronave e Strehimit, emëruar me urdhrin nr. 451 prot., datë 17.03.2016.
46. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori i Strehimit, Drejtoria e Aseteve, Pronave e Strehimit, emëruar me urdhrin nr. 765 prot., datë 22.09.2015.
47. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori i Pronave, Drejtoria e Aseteve, Pronave e Strehimit, emëruar me urdhrin nr. 746 prot., datë 23.05.2016.

48. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste Juriste*”, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 717 prot., datë 12.05.2016.
49. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist IT*”, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 1193 prot., datë 07.12.2015.
50. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist IT*”, Drejtoria e Politikave të Zhvillimit Ekonomik, emëruar me urdhrin nr. 512 prot., datë 31.03.2016.
51. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Programeve Sociale, Drejtoria e Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 788 prot., datë 22.09.2015.
52. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Programeve Sociale, Drejtoria e Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 391 prot., datë 03.07.2014.
53. *****; në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse Sektori Ndihmës Ekonomike*”, Drejtoria e Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 802 prot., datë 25.09.2015.
54. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori Ndihmës Ekonomike, Drejtoria e Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 1227 prot., datë 15.12.2015.
55. *****; në pozicionin e punës “*Specialist*”, Sektori Ndihmës Ekonomike, Drejtoria e Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 1226 prot., datë 15.12.2015.
56. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori Ndihmës Ekonomike, Drejtoria e Kujdesit Social, emëruar me urdhrin nr. 642 prot., datë 29.04.2016.
57. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori Trashëgimisë Kulturore, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Rinisë e Sporteve, emëruar me urdhrin nr. 671 prot., datë 04.09.2015.
58. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori Sportit, Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, Rinisë e Sporteve, emëruar me urdhrin nr. 705 prot., datë 11.05.2016.
59. *****; në pozicionin e punës, “*Drejtor*”, Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit, emëruar me urdhrin nr. 3 prot., datë 06.01.2016.
60. *****; në pozicionin e punës, “*Përgjegjëse Sektorit Arsimit Parashkollor*”, Drejtoria Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit, emëruar me urdhrin nr. 40 prot., datë 20.01.2016.
61. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori i Arsimit Parashkollor, Drejtoria Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit, emëruar me urdhrin nr. 38 prot., datë 20.01.2016.
62. *****; në pozicionin e punës, “*Specialiste*”, Sektori i Arsimit Parashkollor, Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit, emëruar me urdhrin nr. 355 prot., datë 07.03.2016.
63. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Edukimit Rinor, Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit, emëruar me urdhrin nr. 124 prot., datë 12.03.2015.
64. *****; në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Edukimit Rinor, Drejtoria e Politikave të Arsimit Parashkollor dhe Edukimit, emëruar me urdhrin nr. 461 prot., datë 21.03.2016.
65. *****; në pozicionin e punës, “*Drejtor i Përgjithshëm*”, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Infrastrukturore, emëruar me urdhrin nr. 379 prot., datë 09.03.2016.
66. *****; në pozicionin e punës, “*Drejtor*”, Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, emëruar me urdhrin nr. 559 prot., datë 07.04.2016.

67. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist Sektori i Sipërfaqeve Urbane dhe Emergjencave Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban*” emëruar me urdhrin nr. 140 prot., datë 27.03.2014.
68. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Transportit, Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, emëruar me urdhrin nr. 637 prot., datë 01.09.2015.
69. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Transportit, Drejtoria e Shërbimit të Territorit Urban, emëruar me urdhrin nr. 54 prot., datë 25.01.2016.
70. *****, në pozicionin e punës, “*Drejtor*”, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 119 prot., datë 10.02.2016.
71. *****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Sektori Vlerësimit dhe Përballimit*”, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 713 prot., datë 12.05.2016.
72. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Vlerësimit dhe Përballimit, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 719 prot., datë 12.05.2016.
73. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Vlerësimit dhe Përballimit, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 537 prot., dt. 05.04.2016.
74. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori i Vlerësimit dhe Përballimit, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 720 prot., datë 12.05.2016.
75. *****, në pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Sektorit të Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit*”, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 714 prot., datë 12.05.2016.
76. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori të Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 531 prot., datë 01.04.2016.
77. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori të Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit, Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 525 prot., datë 01.04.2016.
78. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Sektori të Kryerjes së Procedurave dhe Parandalimit Drejtoria e Emergjencave Civile, emëruar me urdhrin nr. 718 prot., datë 12.05.2016.
79. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist*”, Drejtoria e Shërbimeve Bujqësore, Blegtoriale, Tokave e Pyjeve, emëruar me urdhrin nr. 847 prot., datë 13.10.2015.
80. *****, në pozicionin e punës, “*Inspektore Inspektoriatit Mjedisit*”, emëruar me urdhrin nr. 199 prot., datë 16.02.2016.
81. *****, në pozicionin e punës, “*Specialist i Urbanistikës lagja Nr. 1 dhe Nr. 2*”, emëruar me urdhrin nr. 206 prot., datë 05.05.2015.
82. *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike Lagja Nr. 2*”. emëruar me urdhrin nr. 1206 prot., datë 09.12.2016.
83. *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike Lagja Nr. 2*”, emëruar me urdhrin nr. 12 prot., datë 13.01.2015.
84. *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike Lagja Nr. 3*”, emëruar me urdhrin nr. 390 prot., datë 02.07.2014.
85. *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike Lagja Nr. 6*”, emëruar me urdhrin nr. 548 prot., datë 06.04.2016.
86. *****, në pozicionin e punës, “*Specialiste e Ndhmës Ekonomike Lagja Nr. 6*”, emëruar me urdhrin nr. 640 prot., datë 11.09.2014.

87. *****, në pozicionin e punës “*Specialiste e Urbanistikës Lagja Nr. 5 e 6*”, emëruar me urdhrin nr. 864 prot., datë 09.10.2015.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur këta punonjës janë marrë në punë, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili parashikon se rekrutimi në shërbimin civil kryhet vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, për të gjitha rastet e mësipërme, të anulojë aktin e emërimit. Në mbështetje të këtij konkluzioni vijnë parashikimet e nenit 23, pika 4, të ligjit për nëpunësin civil, të cilat e konsiderojnë aktin e emërimit në këtë rast si absolutisht të pavlefshëm, i cili nuk mund të prodhojë pasoja ligjore.

Për këtë arsye njësia përgjegjëse duhet të vendosë menjëherë, përfundimin e kësaj marrëdhënie punësimi dhe pozicionet e përshkuara më sipër, duhet të shpallen si të lira, me qëllim që të plotësohen nëpërmjet procedurave të konkurrimit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe me strukturën aktuale e atë pasardhëse, që pritet të miratohet në fund të vitit në vazhdim.

Gjithashtu, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Elbasan, që të tregojë kujdes në zbatimin e ligjit dhe për pasojë të gjitha rastet e rekrutimeve të reja, të lëvizjeve paralele dhe ngritjes në detyrë t'i realizojë në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, si dhe të udhëzimeve të dala prej Departamentit të Administratës Publike, të cilat disiplinojnë këto procese.

IV. Instituti i transferimit të përkohshëm dhe transferimit të përhershëm dhe si janë respektuar kërkesat ligjore në këto raste.

Gjatë verifikimit u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, **nuk kishte asnjë rast** të kryerjes së procedurave ligjore të transferimit të përkohshëm dhe transferimit të përhershëm, në pozicionet pjesë të shërbimit civil, në përputhje me kërkesat e ligjit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në kapitullin e ngritjes në detyrë, të cilat ashtu si edhe janë sqaruar në përmbajtjen e këtij kapitulli, janë realizuar në kundërshtim me ligjin.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Elbasan, që në rast se, do të nevojitet aplikimi i procedurave të transferimit të përkohshëm dhe transferimit të përhershëm, duhet mbajnë parasysh dhe të respektojnë kërkesat dhe procedurën e parashikuar në nenin 48, e vijues, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë*”.

V. Pezullimi nga shërbimi civil

Gjatë verifikimit u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, **nuk u evidentua asnjë rast** i aplikimit të

procedurave të pezullimit nga shërbimi civil, sipas kërkesave të neneve 53, deri 56, të ligjit në fjalë.

Konkluzion: Në këto rrethana, Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Elbasan, që në rast se, do të nevojitet zbatimi i këtyre procedurave ligjore, duhet të respektojë kërkesat e dispozitave të mësipërme të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”.

VI. Masat disiplinore dhe respektimi i procedurës ligjore

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u verifikuan procedurat administrative disiplinore të realizuara nga institucioni përgjatë periudhës objekt mbikëqyrje (nga fillimi i efekteve juridike të ligjit deri në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes).

Shkelja e detyrimeve që e ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin civil, llojet e shkeljeve dhe masave disiplinore, organi kompetent disiplinor dhe procedurat që duhet të ndiqen në një procedim disiplinor janë të përcaktuara në Kreun X, “Disiplina në shërbimin civil”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, nenet nga 57 deri në 61, në vendimin nr.115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Shkeljet disiplinore shumë të rënda janë përcaktuar në pikën 2, të nenit 57, të ligjit dhe në këtë rast, masa disiplinore që zbatohet ndaj nëpunësit civil, është “largim nga shërbimi civil”, i parashikuar në shkronjën “ç”, të nenit 58, të ligjit në fjalë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, lidhur me zbatimin e masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë, u konstatua se në Bashkinë Elbasan dhe ish-Komunat që përfshihen aktualisht në këtë institucion, duke filluar nga viti 2013, e deri në momentin e realizimit të kësaj mbikëqyrje, u konstatua se, “largimi nga shërbimi civil”, i parashikuar si ndëshkimi administrativ më i rëndë për një nëpunës civil, është zbatuar në **2 raste**. Konkretisht, bëhet fjalë për nëpunëset ***** dhe *****.

1. Nëpunësja ***** ka filluar punë në datën 05.06.2012, në pozicionin e punës “Specialiste e Ndihmës Ekonomike”, në Rajonin nr. 2, Njësi Administrative pranë Bashkisë Elbasan. Me vendimin nr. 2, datë 23.10.2015, të Komisionit Disiplinor, rezulton se është marrë masa disiplinore “largim nga shërbimi civil”, për shkak të mungesës së pajustificuar dhe të vijueshme në punë. Komisioni Disiplinor është ngritur me aktin nr. 841 prot., datë 07.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan.

Gjatë shqyrtimit të këtij procedimi administrativ disiplinor, konstatohet se të gjithë vendimmarrjet e Komisionit Disiplinor janë bërë në mbështetje të përcaktimeve të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr.115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të

rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil". Konkretisht, gjatë procedimit administrativ disiplinor është garantuar e drejta e nëpunësit për t'u njoftuar lidhur me fillimin e procedimit (njoftimi nr. 561 prot., datë 07.10.2015) dhe nga ana e Komisionit Disiplinor janë mbajtur disa proces-verbale ku janë evidentuar të gjitha faktet dhe janë vlerësuar rrethanat e ngjarjes që kanë qenë të nevojshme për marrjen e vendimit në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative (proces-verbal i datës 15.10.2015, proces-verbal i datës 21.10.2015, proces-verbal i datës 23.10.2015).

Punonjësja ***** e ka ankimuar aktin e largimit nga shërbimi civil, Vendimin nr. 2, datë 23.10.2015, të Komisionit Disiplinor, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, e cila në përfundim të shqyrtimit ka vendosur pranimin e padisë. Institucioni ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe çështja është në pritje për shqyrtim.

2. Nëpunësja ***** ka filluar punë në datën 07.02.20108, në pozicionin *"Drejtores e Drejtorisë së Informacionit"* pranë Bashkisë Elbasan. Me urdhrin nr.69, datë 19.02.2016, të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, është liruar nga detyra për shkak të mungesës së pajustificuar dhe të vijueshme në punë.

Nëpunësja ***** nuk e ka ankimuar aktin e largimit nga shërbimi civil në Gjykatën Administrative kompetente për të shqyrtuar këtë çështje.

Në këtë rast, konstatohet se për largimin nga shërbimi civil të kësaj nëpunëseje nuk është realizuar procedura administrative disiplinore, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar dhe Kreut II, të vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*.

Konkluzion: Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se rastin e nëpunëses ***** Komisioni Disiplinor ka vepruar drejt duke respektuar dispozitat dhe procedurën e parashikuar në Kreun X, *"Disiplina në shërbimin civil"* që përfshin nenet 57, deri 61, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar; Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimi civil"* dhe Udhëzimit nr. 1, datë 02.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, *"Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore"*.

Lidhur me rastin e nëpunëses ***** Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse nuk i ka respektuar kërkesat e nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar dhe Kreut II, të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*.

Në kushtet kur nga ana e punonjësit nuk është bërë ankim, njësia përgjegjëse në të ardhmen, duhet të tregojë kujdes të posaçëm në lidhje me respektimin e procedurave gjatë një ecurie disiplinore, për të garantuar të drejtat e nëpunësit, si edhe dhënien e një mase disiplinore në përputhje me rëndësinë e shkeljes së kryer.

VII. Vlerësimi i rezultateve në punë

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, (Kreu XI, neni 62), përcakton detyrimin e institucioneve për të vlerësuar punën e çdo punonjësi që kryen funksione në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Sistemi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i rëndësishëm, i cili konsiston në verifikimin e realizimit të përgjithshëm të objektivave të përcaktuara në fillim të periudhës së vlerësimit, si dhe i aftësive dhe dobësive të nëpunësit në kryerjen e detyrave. Ai i shërben përmirësimit të aftësive profesionale të nëpunësit civil dhe të cilësisë së shërbimit dhe ka pasoja të rëndësishme për nëpunësin civil, pasi shërben për të marrë vendime objektive në lidhje me periudhën e provës, mundësinë e zhvillimit të karrierës nëpërmjet ngritjes në detyrë, lirim nga shërbimi civil, përparimin në hapat e pagës si dhe në përcaktimin e nevojave për trajnim dhe zhvillim profesional të nëpunësit civil.

Në kuptim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që duhet të realizohet çdo 6 muaj, ose çdo vit, ku viti i vlerësimit për nëpunës civil të konfirmuar është i njëjtë me vitin kalendarik, me përjashtim të vlerësimit të rezultateve në punë në përfundim të periudhës së provës, ku viti i vlerësimit llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil. Për realizimin e një vlerësimi sa me objektiv, në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, është përcaktuar një procedurë e hollësishme në lidhje me kompetencat e aktorëve që marrin pjesë në këtë proces dhe mënyrën e kryerjes së këtij procesi.

Në kuptim të pikës 12, Kreut II, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë është një proces i vazhdueshëm, i cili kalon në fazat e mëposhtme:

- *Planifikimi, ku zyrtari raportues gjatë 15-ditëshit të dytë të muajit dhjetor, cakton për nëpunësin civil që do të vlerësohet, objektivat kryesore të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në këtë fazë zyrtari raportues, pra eprori direkt, së bashku me nëpunësin që do të vlerësohet diskutojnë qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.*
- *Bisedimet e ndërmjetme. Kjo fazë konsiston në takime të strukturuar dhe të shkurtra, të cilat zhvillohen gjatë vitit, çdo katërmujor, ku zyrtari raportues takohet me nëpunësin civil dhe vlerëson progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara dhe përmirësimet e nevojshme në planin e hartuar me shkrim.*
- *Vlerësimi përfundimtar, i cili realizohet në periudhën 15 nëntor - 15 dhjetor dhe konsiston në vlerësimin e përmbledhur të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.*

Pas kontrollit të ushtruar në lidhje me procesin e vlerësimeve të nëpunësve, në zbatim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014 të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”, është konstatuar se, për periudhën 2014 – 2015, në subjektin e mbikëqyrur janë vlerësuar nëpunësit civilë, për rezultatet individuale në punë, në këtë mënyrë:

- a) në nivelin 1 “shumë mirë” – 24 nëpunës civilë;
- b) në nivelin 2 “mirë” – 12 nëpunës civilë;
- c) në nivelin 3 “kënaqshëm” – 0 nëpunës civil;
- d) në nivelin 4 “jokënaqshëm” – 0 nëpunës civil.

Kjo situatë e pasqyruar, pavarësisht faktit se ka vështirësi reale për t'u matur nga jashtë, në lidhje me saktësinë dhe efikasitetin e akteve të kësaj natyre, ku vendimmarrja është në diskrecionin e eprorit direkt, tregon për elemente të një qëndrimi subjektiv dhe formal, duke i vlerësuar të gjithë punonjësit e përfshirë në këtë proces në nivele shumë të larta, “Shume mirë” dhe “Mirë”.

Në këto rrethana, nga ana e njësisë përgjegjëse duhet të tregohet kujdes, duke e drejtuar procesin e vlerësimit, drejt pasqyrimin real të gjendjes së nëpunësve civilë, duke e lidhur atë me realizimin e detyrave konkrete të secilit punonjës, me qëllim që të arrihen vlerësime objektive sipas cilësisë së punës së kryer.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në përgjithësi njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, nuk e ka realizuar të plotë procesin e vlerësimit të rezultateve të punës, për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil, sipas kërkesave të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një detyrim ligjor të paplotësuar nga ana e njësisë përgjegjëse.

Mosplotësimi i këtij detyrimi ligjor, bëhet pengesë për të përcaktuar cilësinë e punës së nëpunësve civilë, funksionimin e sistemit të zhvillimit të karrierës dhe plotësimin të elementëve të tjerë të shërbimit civil, si psh, në rastet kur nëpunësi civil mund të jetë i interesuar të bëjë lëvizje paralele, apo të kërkojë ngritje në detyrë, etj.

Detyrë e njësisë përgjegjëse në këtë rast është plotësimi i menjëhershëm i kësaj mangësie, duke mbajtur parasysh që vlerësimet e rezultateve të punës të kryhen me objektivizëm, duke respektuar procedurën e parashikuar në aktet ligjore e nënligjore përkatëse, duke evituar njëjësimit dhe tendencën për vlerësime maksimale, pa e mbështetur këtë në rezultatet dhe arritjet në përmbushjen e objektivave, me qëllim stimulimin dhe rritjen e performancës në punë.

Gjithashtu, detyrë tjetër e njësisë përgjegjëse në këtë rast, mbetet që të sjellë sistemin e vlerësimit të punës, sa më afër realitetit, i cili ka lidhje me realizimin e detyrave konkrete të nëpunësve, si dhe me zbatimin e procedurave që kërkohen nga ligji dhe aktet nënligjore në këtë rast. Kjo arrihet nëpërmjet trajnimit të të gjithë aktorëve të këtij sistemi, të cilët janë në rolin e nëpunësit autorizues dhe raportues, si dhe disiplinimin e tyre për të mbajtur shënime, për çdo nëpunës civil, sipas afateve ligjore të analizuara më sipër, në pjesën hyrëse të kësaj rubrike.

VIII. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si rezultat i dorëheqjes, ose për shkak të ligjit

Nga verifikimi i dokumentacionit që lidhet me institutin e lirimit nga shërbimi civil, u konstatua se për periudhën objekt mbikëqyrje, në institucionin e kontrolluar, në Bashkinë Elbasan dhe në komunat që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, evidentohen **29 raste** në të cilat ka përfunduar marrëdhënia e punës në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil, si më poshtë:

- Në **14 raste**, marrëdhënia e punës në shërbimin civil, ka përfunduar nëpërmjet institutit të dorëheqjes, e cila njihet si një nga mënyrat e lirimit nga shërbimi civil, në bazë të nenit 64, pika 1 dhe nenit 66, shkronja “dh”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Në gjithë këto raste, nëpunësit kanë paraqitur kërkesë me shkrim, për përfundimin e marrëdhënies së punës në shërbimin civil. Të gjitha rastet e trajtuara sipas dispozitave të mësipërme ligjore, janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 5 - Aktet që materializojnë procesin e largimit nga shërbimi civil**, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

- Në **12 raste**, marrëdhënia e punës në shërbimin civil, ka përfunduar për shkak të ligjit, kur plotësohet moshja për pensionin e plotë të pleqërisë, e cila njihet si një nga mënyrat e lirimit nga shërbimi civil, në bazë të nenit 65, pika 1, shkronja “b” dhe nenit 66, shkronja “ë”, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Në gjithë këto raste, nëpunësit kishin plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë. Të gjitha rastet e trajtuara sipas dispozitave të mësipërme ligjore, janë të pasqyruara në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 5 - “Aktet që materializojnë procesin e largimit nga shërbimi civil”**, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

- Në **2 raste**, marrëdhënia e punës në shërbimin civil, ka përfunduar për shkak të masës disiplinore, e cila njihet si një nga mënyrat e lirimit nga shërbimi civil, në bazë të nenit 63, shkronja “b” dhe nenit 66, shkronja “ë”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Në këto raste, nëpunësit janë larguar nga shërbimi civil për shkak të masës disiplinore. Këto raste, të trajtuara më sipër, janë të pasqyruara në **Tabelën nr. 5 – “Aktet që materializojnë procesin e largimit nga shërbimi civil”**, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

- Në **1 rast**, marrëdhënia e punës në shërbimin civil, ka përfunduar si rezultat i ristrukturimit të institucionit, e cila njihet si një nga mënyrat e lirimit nga shërbimi civil, në bazë të nenit 66, shkronja “a/1”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

Bëhet fjalë për nëpunësin civil *****, i emëruar në pozicionin e punës “Inspektor në Inspektoriatin Veterinar Ushqimor”, i cili është larguar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 85, datë 24.02.2015, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Konstatohet se në këtë rast, nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në dispozitën përkatëse që rregullon këtë institut të ligjit për nëpunësin civil.

Ky rast i trajtuar sipas dispozitës së mësipërme ligjore, është pasqyruar në mënyrë të detajuar në **Tabelën nr. 5** - *“Aktet që materializojnë procesin e largimit nga shërbimi civil”*, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, në përgjithësi njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, ka vepruar drejt në lidhje me përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të lirimit nga shërbimi civil si rezultat i dorëheqjes ose për shkak të ligjit, në bazë të nenit 64 dhe 66, pika 1, shkronja *“dh”* dhe *“ë”*, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Nga ana tjetër, në rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, si rezultat i ristrukturimit të institucionit, në bazë të nenit 66 pika 1, shkronja *“a/1”*, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Komisioneri vlerëson se njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan, ka vepruar në kundërshtim me ligjin, sepse nuk është respektuar procedura që përcaktohet në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Në këto rrethana, njësia përgjegjëse e Bashkisë Elbasan për të rregulluar situatën e paligjshmërisë duhet që: **së pari**, të revokojë urdhrin nr. 85, datë 24.02.2015, për largimin nga shërbimi civil të nëpunësit civil ***** dhe **së dyti**, duhet të zbatojë të drejtat që atij i takojnë si nëpunës civil, në bazë të pikës 1, 2 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke i bërë të ditur këtij punonjësi të drejtën për shpërblim financiar, në bazë të vjetërsisë në punë, dhe të drejtën për të konkurruar si nëpunës civil, nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

IX. Ristrukturimi i institucionit, për shkak të reformës territoriale dhe si është situata aktuale e pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, në raport me situatën në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar

Duke analizuar statistikën e prodhuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, rezultoi se situata aktuale, e krijuar pas ndryshimeve të ndodhura për shkak të riorganizimit administrativo-territorial, mbështetur në ligjin nr.30/2015, *“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar*, është e materializuar në strukturën e miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Elbasan nr. 484, datë 23.03.2016, *“Për miratimin e strukturës provizore të Bashkisë Elbasan për vitin 2016”*.

Bazuar në këtë strukturë rezultojnë që në shërbimin civil bëjnë pjesë **207** punonjës nga **388** punonjës në total. Kjo situatë është e evidentuar në mënyrë të detajuar në **Aneksin nr. 3** - *“Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil të Bashkisë Elbasan dhe Njësive Administrative për vitin 2016”*, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Ndërkohë, situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në Bashkinë Elbasan dhe në 12 ish - Komunat, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013,

“Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, që përkon me datën 26.02.2014, paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Tabelë : Situata në lidhje me pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014.

Nr.	Institucioni	Pozicione pune gjithsej	Pozicione pune në shërbimin civil
1	Bashkia Elbasan	213	150
2	Komuna Tregan	15	8
3	Komuna Shirgjan	33	9
4	Komuna Labinot-Mal	21	8
5	Komuna Zavalinë	14	5
6	Komuna Gjinar	22	8
7	Komuna Bradashesh	28	14
8	Komuna Funar	11	3
9	Komuna Papër	46	15
10	Komuna Gjergjan	21	9
11	Komuna Shushicë	26	9
12	Komuna Gracen	15	4
13	Komuna Labinot-Fushë	14	5
Totali		479	247

Nga analiza e të dhënave të paraqitura më sipër, rezulton se numri total i punonjësve të Bashkisë Elbasan, së bashku me komunat që janë bërë pjesë e kësaj njësie të pushtetit vendor, nga **479 punonjës** që ishin në strukturat e mëparshme, tashmë është **388 punonjës**, pra është zvogëluar me rreth **19%**. Në shërbimin civil nga **247 pozicione pune** gjithsej në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar (data 26.02.2014), me strukturën provizore të vitit 2016, janë **207 pozicione pune**, pra kemi një zvogëlim të numrit të punonjësve në shërbimin civil në masën rreth **16%**.

Kjo do të thotë se ky institucion është përfshirë në proces ristrukturimi, i cili në thelbin e tij përbëhet jo vetëm me zvogëlim në pikëpamjen numerike të pozicioneve të punës por dhe riorganizime nga pikëpamja e përmbajtjes së tyre.

Në kuadër të detyrës së caktuar, për verifikimin e mënyrës së zbatimit të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, u analizua mënyra e kryerjes së procedurës së ristrukturimit, në përfundim të të cilës rezultoi se: nuk ishte respektuar asnjë nga rregullat e kërkuara nga ligji; nuk është ngritur Komisioni i Ristrukturimit dhe nuk është respektuar procedura që përcaktohet në nenin 50, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kriteret bazë mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit, janë kushtet e parashikuara në dispozitën e përmendur më sipër, si dhe në Vendimet nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë

25.03.2015 dhe nr. 171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” të Këshillit të Ministrave, aktualisht i shfuqizuar me Vendimin nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”, të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht, është vlerësuar fakti nëse:

- Nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit të institucionit, janë të çertifikuar si nëpunës civilë, në përputhje me kërkesat e nenit 67, pika 3 dhe 6, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në cilin pozicion pune ka qenë secili nëpunës para procesit të ristrukturimit dhe në cilin pozicion është sistemuar pas tij.
- Akt-Verifikimi mbi përmbajtjen e dosjesve së personelit dhe deklarimin e statusit të nëpunësve që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e përgjithshme e të veçanta të këtyre pozicioneve dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.
- Aktet e lirim të nëpunësve të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit, që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës të krijuar rishtas apo ristrukturuar, sipas përshkrimeve të reja.

Nisur nga përmbajtja e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, rezulton se është njësi përgjegjëse, subjekti që drejton gjithë procesin nga ana ligjore.

Në rastin konkret, njësi përgjegjëse e Bashkisë Elbasan nuk ka ndjekur procedurat në përputhje me ligjin, pasi në tërësi, nuk është respektuar asnjë nga kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Në këto kushte, njësi përgjegjëse e Bashkisë Elbasan duhet të vihet para përgjegjësisë disiplinore, për moskryerje si duhet të detyrës dhe të marrë masat e menjëhershme për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë në këtë drejtim.

Për këtë, duhet të dalë akti përkatës i kryetarit të bashkisë për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, i cili duhet të marrë në shqyrtim e të bëjë vlerësimin përkatës për mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotëson kërkesat specifike. Vendimi përfundimtar i riemërimit/transferimit pas ristrukturimit, do të merret nga njësi përgjegjëse e cila ka edhe detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirim nga shërbimi civil për ata nëpunës të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës apo që u është ristrukturuar për shkak të ndryshimit të përshkrimit dhe kërkesave të përgjithshme e të veçanta të vendit të punës.

Kujdes i veçantë duhet të tregohet sidomos për respektimin e të gjitha të drejtave që parashikon pika 7, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për

punonjësit të cilët do të lirohen apo janë liruar nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, ndër të cilat e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, e drejta për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t'u emëruar në mënyrë të përkohëshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Mosrespektimi i kësaj procedure, ka sjellë si pasojë edhe shkelje ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse, të cilat konsistojnë në emërimë pa konkurrim në kundërshtim me ligjin nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar. Janë konstatuar **98 raste**, ku janë emëruar punonjës në kundërshtim me ligjin, në kushtet, kur numri i nëpunësve civilë është zvogëluar me **40** pozicione pune në shërbimin civil, si dhe aplikim të gabuar të institutit të transferimit, duke emëruar nëpunës civilë në pozicione me nivel më të lartë në hierarkinë e shërbimit civil, në krahasim me statusin e tyre në shërbimin civil, për punonjësit si më poshtë:

➤ Gjatë mbikëqyrjes u konstatua se, në institucionin e mbikëqyrur, pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, *“Për shërbimin civil”*, i ndryshuar, në **10 raste**, njësia përgjegjëse ka aplikuar në mënyrë të gabuar institutin e transferimit, në një kohë kur, duhet të kishte vepruar në përputhje me procedurat e ngritjes në detyrë për pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se punonjësit, të cilët do të analizohen më poshtë, janë transferuar në pozicione pune, të kategorive më të larta, krahasuar me kategorinë e pozicionit të punës ku ata kanë fituar statusin e nëpunësit civil, çka bie në kundërshtim me kërkesat e dispozitës që rregullon institutin e transferimit të përkohshëm. Kjo dispozitë lejon lëvizjen vetëm në pozicione pune me të njëjtën kategori (neni 48 i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar).

Në këtë rast, njësia përgjegjëse, duhet të anulojë aktet e transferimit dhe punonjësit që kanë plotësuar këto pozicione pune, duhet të trajtohen nga Komisioni i Ristrukturimit, për t'u sistemuar në një pozicion të përshtatshëm, ku ata i plotësojnë kërkesat e veçanta të vendit të punës. Punonjësit e emëruar aktualisht në këto pozicione, nuk kanë asnjë pengesë të aplikojnë për të konkurruar për ngritje në detyrë, nëse i plotësojnë kërkesat specifike për këto pozicione pune, nëse ato mbesin të lira pas përfundimit të procedurave të ristrukturimit.

Bëhet fjalë për punonjësit si më poshtë:

1. ***** – ka filluar punë, me urdhrin nr. 719, datë 17.12.2012 në pozicionin e punës, *“Specialiste, në Sektorin e Prokurimeve, në Drejtorinë e Menaxhimit të Aseteve e Prokurimeve Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projektimeve e Prokurimeve”*, dhe më pas, me urdhrin nr. 885, datë 08.10.2015, është transferuar në një pozicion më të lartë në hierarkinë e shërbimit civil, konkretisht në pozicionin e punës, *“Përgjegjës në Sektorin e Pronave”*, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se, nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë, në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, në këtë rast duhet të anulojë aktin e transferimit (*emërimit*) nr. 885, datë 08.10.2015 dhe kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “Përgjegjës në Sektorin e Pronave”, duhet të shpallet i lirë, për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

2. ***** – ka filluar punë me vendimin nr. 22, datë 09.05.2006 në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Drejtorinë e Projektim Standartizimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Menaxhimit të Aseteve, Projektiveve e Prokurimeve”. Me urdhrin nr.639, datë 31.08.2015, kjo punonjëse është transferuar në pozicionin e punës, “Drejtor në Drejtorinë e Detyrave të Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, në këtë rast duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 639, datë 31.08.2015 dhe si në rastin e mësipërm, kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “Drejtor në Drejtorinë e Detyrave të Standartizimit dhe Azhornimit të Tokave”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

3. ***** – ka filluar punë me vendimin nr. 46, datë 08.02.2008 në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Asistencës Ligjore në Drejtorinë Juridike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Organizative”. Me urdhrin nr. 160, datë 31.03.2015, kjo punonjëse është transferuar në pozicionin e punës, “Drejtor në Drejtorinë Juridike”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, në këtë rast duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 160, datë 31.03.2015 dhe si në rastin e mësipërm, kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “*Drejtor në Drejtorinë Juridike*”, duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

4. ***** – ka filluar punë me vendimin nr. 67, datë 08.02.2008 në pozicionin e punës, “*Specialiste në Sektorin e Asistencës Ligjore në Drejtorinë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Organizative*”. Me urdhrin nr. 159, datë 31.03.2015, punonjësja është transferuar në pozicionin e punës, “*Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Asistencës Ligjore në Drejtorinë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Organizative*”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 159, datë 31.03.2015 dhe si në rastin e mësipërm, kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “*Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Asistencës Ligjore në Drejtorinë Juridike në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Organizative*”, duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

5. ***** – ka filluar punë me vendimin nr. 81, datë 19.02.2008 në pozicionin e punës “*Përgjegjës Sektori në Sektorin e Informimit Qytetar në Drejtorinë e Informacionit*”. Me urdhrin nr. 1179, datë 20.11.2015, punonjësi është transferuar në pozicionin e punës, “*Drejtor i Informacionit*”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, në këtë rast duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 1179, datë 20.11.2015 dhe ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “*Drejtor i Informacionit*”, duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

6. ***** – ka filluar punë me urdhrin nr. 410, datë 10.10.2013 në pozicionin e punës, “*Specialist në Sektorin e Rregjistrimit dhe Mbledhjes në Drejtorinë e Tatim Taksave*”. Me urdhrin nr. 374, datë 03.06.2016, punonjësi është transferuar në pozicionin e punës,

“Përgjegjës Sektori, në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore Rinisë e Sporteve Kulturore”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 374, datë 03.06.2016 dhe si në rastin e mësipërm, ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, *“Përgjegjës në Drejtorinë e Trashëgimisë Kulturore Rinisë e Sporteve Kulturore”*, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

7. ***** – ka filluar punë me urdhrin nr. 25, datë 10.01.2012 në pozicionin e punës, *“Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit”*. Me urdhrin nr. 422, datë 31.08.2015, punonjësja është transferuar në pozicionin e punës, *“Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Operacionale”*, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse në këtë rast, duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 422, datë 31.08.2015 dhe si në rastin e mësipërm, kjo nëpunëse duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, *“Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Operacionale”*, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

8. ***** – ka filluar punë me urdhrin nr. 24, datë 10.01.2012 në pozicionin e punës, *“Specialist, në Sektorin e Planifikimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit e Kontrollit të Territorit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit”*. Me urdhrin nr. 779, datë 17.09.2015, punonjësi është transferuar në pozicionin *“Përgjegjës Sektori, në Sektorin e Planifikimit të Territorit”*, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, në këtë rast, duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 779, datë 17.09.2015 dhe ashtu si është rekomanduar më sipër, ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Planifikimit të Territorit”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

9. ***** – ka filluar punë me urdhrin nr. 368, datë 13.04.2012 në pozicionin e punës, “Specialist Transporti, në Sektorin e Sipërfaqeve Urbane, Emegjencave dhe Transportit në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban, në Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit Urbanistik dhe Territorit”. Me urdhrin nr. 872, datë 12.10.2015, punonjësi është transferuar në pozicionin e punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse, duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 872, datë 12.10.2015 dhe si në rastin e mësipërm, ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Transportit, në Drejtorinë e Shërbimit të Territorit Urban”, duhet të shpallet i lirë për t’u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

10. ***** – ka filluar punë me urdhrin nr. 393/1, datë 09.05.2012 në pozicionin e punës, “Inspektor në Inspektoriatin e Mjedisit”. Me urdhrin nr. 82, datë 24.02.2015, punonjësi është transferuar në pozicionin e punës, “Përgjegjës në Inspektoriatin e Mjedisit”, deri në miratimin e strukturës së re administrative të Bashkisë Elbasan.

Nga verifikimi në këtë rast, rezulton se nga ana e njësisë përgjegjëse nuk është vepruar drejt, sepse nuk janë respektuar procedurat e ngritjes në detyrë në përputhje me nenin 26, të ligjit për nëpunësin civil.

Në këtë rast, ashtu si e analizuam në hyrje të rubrikës, duhet të zbatohen procedurat e ristrukturimit.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se, njësia përgjegjëse duhet të anulojë aktin e transferimit nr. 82, datë 24.02.2015 dhe si në rastin e mësipërm, ky nëpunës duhet të trajtohet sipas procedurës së ndjekur gjatë ristrukturimit, parashikuar nga neni 50, i ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Pozicioni i punës, “Përgjegjës në Inspektoriatin e Mjedisit”, duhet të shpallet i lirë për t`u plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore, në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Elbasan.

Në përfundim sa analizuar në këtë kapitull, Komisioneri vlerëson se në Bashkinë Elbasan, nuk është aplikuar procedura e ristrukturimit, sipas parashikimeve ligjore. Për të rregulluar ligjshmërinë në këtë rast, njësia përgjegjëse duhet të fillojë procesin nga e para, duke ndjekur radhën e punës si më poshtë:

a) Të ngrihet Komisioni i Ristrukturimit, me përbërje sipas strukturës së përcaktuar në pikën 5, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014 i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, i cili, bazuar në pikat 3, 7 dhe 8, të dispozitës së mësipërme, ka të drejtën dhe detyrimin që të propozojë para njësisë përgjegjëse sistemimin/transferimin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilëve u është shkurtuar apo riorganizuar pozicioni i punës dhe do të largohen për shkak të ristrukturimit.

b) Përmbyllja e procesit me vendimin përfundimtar për lirim nga shërbimi civil, apo rrimërimin në pozicione të të njëjtës kategori, sipas dispozitave të mësipërme, do të bëhet nga njësia përgjegjëse, pasi të analizohen dhe vlerësohen propozimet e Komisionit të Ristrukturimit.

Në këtë rast, akti i emërimit duhet të jetë nominal për çdo punonjës, ku të përcaktohet pozicioni i punës dhe kategoria e pagës.

Duhet të tregohet kujdes, që në rastet e uljes në detyrë të punonjësit, duhet të merret mendimi i tij me shkrim për pranimin, ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

c) Të kryhet sa më shpejt, hartimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi përbën një proces të domosdoshëm dhe parakusht, për të realizuar risistemimin e punonjësve në të njëjtin pozicion, në një pozicion tjetër të ngjashëm, ku ata plotësojnë kërkesat e veçanta, apo rregjistrimin e tyre në listën e pritjes.

Kjo për faktin se puna e Komisionit të Ristrukturimit është e lidhur me krahasimin e kërkesave specifike për pozicionin e punës, ç`ka është një rubrikë e rëndësishme, që përfshihet në formularin e përshkrimit të punës.

Kujdes i veçantë duhet të tregohet sidomos për respektimin e të gjitha të drejtave që parashikon pika 7, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, të ndryshuar, për punonjësit të cilët lirohen nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, ndër të cilat e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, e drejta për të konkurruar për një periudhë 2 vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe e drejta për t`u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

X. Pasqyrimi i procesit të deklarimit të statusit të punësimit në dosjen e personelit

a. Dosja e Personelit

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u verifikuan dosjet e personelit për të parë nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe sipas kërkesave të Vendimit nr.117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, u konstatua se ishin të përfshira dokumenta me të dhënat personale të karakterit teknik, profesional, si dhe të dhëna të tjera sipas Lidhjes nr. 1 dhe 2, bashkëlidhur aktit nënligjor, që rregullon në mënyrë specifike këtë aspekt.

Më konkretisht, lidhur me dosjet e personelit të Bashkisë Elbasan konstatohet se, në çdo dosje janë të administruara dokumentat e identifikimit (fotokopje e pasaportës); dokumenta që tregojnë për gjendjen civile (çertifikata e gjëndjes familjare); dokumenta që vërtetojnë edukimin arsimor (diploma e shkollës së lartë); dokumenta që vërtetojnë momentin e fillimit të marrëdhënies së punës (akti i emërimit); akte që tregojnë për nivelin e kualifikimit (çertifikata kualifikimi), si dhe aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit.

Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në **Aneksin nr. 2** - “Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, deri në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në Bashkinë Elbasan dhe ish-Komunat”, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Kurse, përsa i përket njësive të pushtetit vendor që aktualisht përfshihen në juridiksionin e Bashkisë Elbasan, konkretisht ish - Komuna Tregan, Komuna Shirgjan, Komuna Labinot-Fushë, Komuna Zavalinë, Komuna Gjinar, Komuna Bradashesh, Komuna Funar, Komuna Papër, Komuna Gjergjan, Komuna Shushicë, Komuna Gracen dhe Komuna Labinot-Fushë, që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, konstatohet se në përgjithsi dosjet e personelit ishin të rregullta.

Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 5, “Parimet e administrimit të shërbimit civil”, ndër të tjera ka përcaktuar se administrimi i shërbimit civil bazohet në parimin e meritës, profesionalizmit dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil. Zbatimi i parimeve dhe mënyra e administrimit të shërbimit civil materializohet në dokumentacionin e administruar në dosjen e personelit, detyrim i cili në njësitë e përmëndura më sipër në përgjithsi ishte respektuar.

Nga analiza e të dhënave konstatohet se, në lidhje me përbërjen gjinore, moshën mesatare dhe institucionet ku kanë kryer arsimin, situata në Bashkinë Elbasan dhe në 12 ish-Komunat, që aktualisht janë njësi administrative të këtij institucioni, paraqitet si më poshtë:

Në datën 26.02.2014 ka pasur 247 pozicione pune në shërbim civil, nga të cilat:

- 135 nëpunës civil janë të gjinisë mashkullore;
- 105 nëpunës civil janë të gjinisë femërore;
- 7 pozicione të lira pune, pjesë e shërbimit civil;

- Moshë mesatare për meshkujt është 50 vjeç;
- Moshë mesatare për femrat është 42 vjeç;
- Moshë mesatare në total është 46 vjeç;

Përsa i përket arsimit të nëpunësve pranë Bashkisë Elbasan rezultojnë të kenë diplomë të studimeve të larta universitare, të marra nga Universitetet Publike të Republikës së Shqipërisë dhe Universitetet Private, nga të cilat:

- 245 nëpunës zotërojnë diplomë të Universiteteve Publike;
- 2 nëpunës zotërojnë diplomë të Universiteteve Private.

Konkluzion: Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dosjet e personelit janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Përgjegjësja e Burimeve Njerëzore, që është edhe përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

b. Regjistri i personelit

Regjistri i personelit është një dokument që duhet të krijohet sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 117, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Në kushtet kur, ende nuk është bërë funksional Regjistri Qendror i Personelit, që sipas ligjit administrohet nga Departamenti i Administratës Publike, në një mënyrë specifike, sipas përcaktimeve të bëra në një akt nënligjor të veçantë, rezulton se të dhënat që përmban regjistri i personelit në institucion, pasqyrojnë gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt.

Konkluzion: Komisioneri rekomandon njësinë përgjegjëse të Bashkisë Elbasan që duhet t’i japë një rëndësi të madhe regjistrit të personelit, i cili është një dokument mjaft i rëndësishëm, që pasqyron gjendjen reale të burimeve njerëzore në këtë subjekt. Nga ana tjetër, duhet të vijojë puna për të plotësuar dosjet e personelit me dokumentet e evidentuara në aneksin përkatës, si të munguara, bashkëngjitur raportit.

*
* *

Këto ish-in rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Elbasan, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.

Aktet administrative që dokumentojnë këtë proces, sipas objektit të tij, janë materializuar në tabelat e mëposhtme respektive për Bashkinë Elbasan dhe 12 ish-Komunat, aktualisht njësi administrative të Bashkisë Elbasan, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij raporti:

- **Tabelën nr. 1** – “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me konkurim sipas ligjit nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil” dhe të konfirmuar si nëpunës civilë, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan”.
- **Tabelën nr. 2** – “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), të cilët kishin më shumë se një vit, në pozicionin e punës, në Bashkinë Elbasan”.
- **Tabelën nr. 3** – “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, emëruar me kontrata, ose akte emërimi të përkohëshme, në kundërshtim me ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”, të cilët kishin më pak se një vit, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014), në Bashkinë Elbasan”.
- **Tabelën nr. 4** – “Aktet që materializojnë procesin e mosdeklarimit të statusit të punësimit për punonjësit që punonin në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014)”.
- **Tabelën nr. 5** – “Aktet që materializojnë procesin e largimit nga shërbimi civil.
- **Aneksi 2** – “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil Bashkia Elbasan dhe ish - Komunat”
- **Aneksi 3** – “Aktet që materializojnë pozicionet e shërbimit civil të Bashkisë Elbasan dhe Njësive Administrative për vitin 2016”.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA